



QEVERISJA VENDORE 2020

Tiranë, 2021



Raporti është përgatitur nga:

AGRON HAXHIMALI

AIDA CACAJ

BLERINA XHANI

Përgjegjësia për faktet dhe opinionet e shprehura në këtë studim bie ekskluzivisht mbi autorët dhe interpretimet e tyre dhe, jo doemos, reflektojnë mendimet apo politikat e Fondacionit Konrad Adenauer.

Tabela e përmbajtjes

Hyrje	7
Përmbledhje ekzekutive	9
Metodologjia	14
Performanca Buxhetore e Njësive të Qeverisjes Vendore për vitin 2020	16
Burimet financiare	18
Ecuria e të ardhurave nga burimet e veta vendore sipas NJQV	19
Shpenzimet e Njësive të Qeverisjes Vendore	21
Ecuria e shpenzimeve sipas Njësive të Qeverisjes Vendore	21
Detyrimet e prapambetura të NJQV	22
Numri i punonjësve të NJQV	24
Stresi financiar i bashkive	25
Legjislacioni që prek qeveritë lokale dhe këndvështrimi i ShBSh	28
Pushteti vendor, sfidat ndaj emergjencave nga tërmeti te pandemia e Covid 19	42
Bashkitë dhe tërmeti	42
Bashkia dhe pandemia	45
Këshilli konsultativ dhe ndërveprimi institucional	49
Aneksë - fakte dhe shifra	51

“Autoritetet lokale dhe rajonale janë linja jonë e parë e mbrojtjes,” deklaroi Presidentja e Komisionit Evropian Ursula Von Der Leyen, duke shtuar se autoritetet lokale kanë të bëjnë me familjen, punëtorët dhe komunitetet dhe se qytetet dhe rajonet duhet të përfshihen që nga fillimi në dialogu kundër pandemisë. Ajo gjithashtu bëri thirrje që autoritetet lokale dhe rajonale të paraqesin një vizion koherent të politikës për të ardhmen e Evropës.

Hyrje

Qeveria lokale në Shqipëri është zëri i 61 bashkive dhe 61 këshillave vendore që së bashku me 320 njësitë administrative përbëjnë nivelin e parë të qeverisjes vendore si dhe 12 Këshillat e Qarqeve që përfaqësojnë nivelin e dytë.

Shoqatat e Bashkive advokojnë në emër të anëtarëve, të cilët janë kryetarë të bashkive, kryetarë të këshillave, këshilltarë, administratorë të njërive si dhe administrata teknike dhe profesionale ekzekutive në bashki. Ne udhëheqim dhe mbështesim angazhimin e pushtetit vendor për të përmirësuar praktikën dhe efikasitetin, duke mundësuar rritjen ekonomike, sociale dhe mjedisore. Mbrojtja dhe përmirësimi i demokracisë lokale dhe decentralizimi është thelbësore për punën tonë.

Ne mbështesim politikat qendrore për reformimin e pushtetit vendor në çdo sektor, ofrojmë alternativat dhe zgjidhjet tona në përputhje me interesin e të zgjedhurve vendorë, të ekonomisë vendore dhe të gjitha këto në përputhje me Kartën Evropiane të Vetqeverisjes Vendore të Këshillit të Evropës.

Misioni i Shoqatës së Bashkive është ti shërbejë interesave të qytetarëve dhe të përmirësojë cilësinë e jetesës së tyre.

Për të arritur misionin tonë ne kemi zhvilluar qëllimet e mëposhtme:

- *Mundësimi dhe inkurajimi i zyrtarëve e qeverisë lokale për të ruajtur dhe përmirësuar shëndetin institucional dhe fiskal duke rritur efikasitetin dhe efektivitetin, duke menaxhuar kostot,*

duke përmirësuar ofrimin e shërbimeve me cilësi dhe sasi sipas standarteve dhe duke qenë llogaridhënës, transparent dhe mbrojtur pasuritë.

- *Promovimi i qeverisjes së mirë dhe reformave në komunitete në të gjithë vendin (61 bashki dhe 12 Qarqe) duke ju ofruar zyrtarëve të qeverisjes vendore informacion të azhurnuar dhe asistencë teknike, sipas nevojës, si dhe rritje kapacitetesh për të zgjedhurit dhe administratën.*
- *Promovim dhe sensibilizim për çështje të integritit evropian, direktivave, normave, kriterëve dhe standarteve të BE ku afro 70 % e këtij legjislacionin prek dhe zbatohet në nivel vendor.*

Përmbledhje ekzekutive

Viti 2020 ishte një vit shumë i vështirë për vendin tonë në tërësi, por veçanërisht i vështirë për pushtetin vendor. Vështirësitë origjinuan nga 30 qershori 2019 me zgjedhjet vendore të njëanshme, pa konkurrencë politike, pa alternativë, jo pluraliste, që nuk kishin ndodhur kurrë më parë që pas vitit 1991. Të 61 bashkitë u fituan nga partia në pushtet, por më e keqja është me parlamentarizmin vendor njëngjyrësh, ku të gjithë këshilltarët vendorë janë nga e njëjta parti në pushtet sikundër kryetari i bashkisë. Ky produkt i 30 qershorit nuk solli përmirësim të demokracisë vendore, humbi kuptimin e debatit dhe alternativës pasi përballja në këshilla mes ekzekutivit dhe legjislativit bëhet thujse memece dhe e verbër çka dëmton shumë demokracinë, dhe çon në mungesë transparence dhe llogaridhënie.

Nga ana tjetër këto zgjedhje shënuan një dëm të madh demokracisë vendore duke krijuar konflikte të mëdha brenda vendit, faktori ndërkombëtar në mënyra të ndryshme bëri të ditur perceptimin negativ për ecurinë e reformave, të demokracisë dhe të zgjedhjeve vendore por jo vetëm. Kjo jo vetëm që nuk ndihmoi, por përkeqësoi shumë aspiratën për integrimin në BE dhe çeljen e negociatave. Institucionet ndërkombëtare kanë mbajtur qëndrime kritike ndaj këtij procesi votimi më 30 qershor. Së pari ishte Kongresi i Autoriteteve Vendore dhe Rajoneve të Këshillit të Evropës që u tërhoq nga misioni i monitorimit të zgjedhjeve. Më pas kemi reagimin nga OSBE/ODHIR dhe Delegacioni i BE etj. *(deklaratat me linqet përkatëse janë në aneksin 1).*

Këto zgjidhje nga mënyra se si u zhvilluan dhe nga produkti që prodhuan përbënin një subjekt ankimimi. Ndaj ShBsh ankimoi zgjedhjet e 30 qershorit në Gjykatën Kushtetuese, e cila e ka pranuar kërkesën si legjitime dhe presim shqyrtimin sapo Gjykata të fillojë funksionimin (*aneks 2 përgjigja e Gjykatës Kushtetuese*).

Veç kësaj vështirësie të krijuar nga mungesa e vizionit politik, bashkitë u ndeshën me dy ngjarje natyrore që nuk parandaloheshin. Dy tërmete, i shtatorit dhe i nëntorit 2019, si dhe pandemia që shoqëroi 10 muajt e vitit 2020, e vendosën pushtetin vendor në pozita të vështira, qoftë në aspektin social qoftë në atë financiar.

Për rastin e menaxhimit të fatkeqsive nga tërmeti ku u prekën gati 15 bashki në tre qarqe, bashkitë edhe pse me njohuri të trashëguara mbi menaxhimin e fatkeqsive, sërish demonstruan mungesë fuqie, profesionale, infrastrukurore, financiare dhe kompetence për të ndërhyrë në zgjidhjen e problemeve. Madje pushteti i tyre nuk u evidentua sa duhet dhe u takon. Ishte pushteti qendror që edhe në këtë rast eklipsoi vëmendjen politike dhe publike me ndërhyrjen në aksionin lokal.

Përsa i takon pandemisë, pushteti vendor edhe pse pa njohuri të mjaftueshme për të tilla raste ndonëse kuadri ligjor ekziston, u perball mirë, dhe morri masa për të parandaluar pandeminë COVID - 19. Ne dy drejtime bashkitë punuan mirë, në dizinfektim dhe pastrim të mjediseve publike dhe në mbështetjen sociale që siguruan për shtresat në nevojë. Por asgjë më shumë për rimëkëmbjen ekonomike.

Si kudo në bashkitë e vendeve të rajonit dhe të Evropës pritej që dhe bashkitë tona të ishin violinë e parë, të punonin më mirë me lokalizimin e COVID 19, dhe të kërkonin mbështetjen që ju takonte për mjete financiare nga qeveria.

Kjo nuk ndodhi nga trysnia që ekziston kur pushteti vendor ka të njëjtin afilititet politik me qeverinë. Këtë difekt të krijuar nga vetë qeveria, ajo e shfrytëzoi shumë mirë, duke i mbajtur larg vëmendjes publike bashkitë, dhe duke përqendruar të gjithë pushtetin ekonomik

e politik, në përballimin e COVID 19 në duart e saj. Kjo çoi në atë që në të dyja paketat e ndihmës bashkitë u përjashtuan nga menaxhimi, dhe pse duhet thënë që paketat ishin jo gjithpërfshirëse, burokratike dhe të pamjaftueshme.

Efektet e tërmetit dhe pandemisë përpos vështirësive institucionale ku u ndodhën bashkitë u ndjenë në tërë arkitekturën institucionale të vendit. Ato sollën vështirësi të mëdha edhe për taksapaguesit në nivel vendor. Dy grupet kryesore taksapaguese: biznesi dhe qytetarët u ndjenë në pozita të vështira lidhur me fuqinë paguese, krahasuar me vullnetin për të paguar.

Kjo bëri që bashkitë të ndesheshin me probleme financiare nga mungesa e të ardhurave të planifikuara nga disa burime, sikundër mbanin mbi supe detyrime të prapambetura dhe borxhe të reja të krijuara gjatë vitit 2020.

Marrë së bashku të integruara, problemet politike nga votimet dhe zgjedhjet jo demokratike vendore të 30 qershorit, problemet me tërmetet dhe pandeminë, niveli i pamjaftueshëm i buxhetit për bashkitë nga transfertat qendrore dhe nga të ardhurat e veta, çuan në një vit jo të mirë për vetë të zgjedhurit, në një vit të vështirë për shërbimet publike vendore qoftë ato tradicionale por edhe funksionet e reja të transferuara si pjesë e strategjisë së decentralizimit. Ndërkohë që qytetarët prisnin më shumë pastrim, gjelbërim, transparencë, përmirësim infrastrukturor, rrugor, shkolla e kopshte, shërbimi bujqësor dhe një ekonomi lokale relativisht të stabilizuar.

Nga këndvështrimi teknik por jo vetëm **konkludojmë** se pushteti vendore ka sfida përpara, është aktualisht jo demokratik, i mungon fuqia dhe pushteti financiar, mjetet financiare që i jep qeveria qendrore janë jo në nivelin e nevojave reale dhe të pakrahasueshme me vendet e rajonit dhe të BE. Shërbimet publike janë jo të mjaftueshme në cilësi dhe sasi, qoftë në zona urbane dhe më keq në zona rurale. Transparenca dhe llogaridhënia duhet të përmirësohen në thelb dhe jo në sipërfaqe.

Ajo çfarë ne **rekomandojmë** shtrihet nga qasja **qendrore** për bashkitë te vetë demokracia dhe decentralizimi i vetë bashkive. Pushteti qendror duhet të kuptojë në thelb decentralizimin dhe të bëjë atë real, dhe jo për marketing. Pushteti qendror duhet ti krijojë pushtetit vendor hapësirën për decentralizim politik, financiar dhe administrativ që i takon. Buxheti nga transfertat e pakushtëzuar për bashkitë duhet dyfishuar nga 1% në 2 % minimalisht, dhe kjo të fillojë të zbatohet në 2022. Buxheti sektorial duhet të jetë pjesë integrale e tërë buxheti të bashkisë. Fondet për investime tashmë të administruara nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit duhet t'ju jepen direkt bashkive. Bashkitë nuk duhet të aplikojnë edhe konkurrojnë te pushteti qendror për shërbimet e tyre.

Qeveria duhet të pregatisë kuadrin ligjor funksional sa më të qartë, të thjeshtë, të kuptueshëm dhe zbatueshëm në nivel vendor, për funksionet dhe përgjegjësitë aktuale, të reja dhe ato që potencialisht ndikojnë në nivel vendor.

Qeveria duhet të përmbyllë kadastrën fiskale prej mungesës së të cilës bashkitë s'po realizojnë të ardhura. Niveli i rentës në favor të bashkive duhet të rritet nga 5% që është aktualisht në të paktën 25-35% dhe ideale do ishte ndarja 50% me 50%. Qeveria qendrore nuk duhet të ndërhyjë në ndryshime ligjore në mes të vitit buxhetor (financiare kryesisht por jo vetëm që efektojnë bashkitë).

Për vetë **bashkitë rekomandojmë** një qasje më demokratike në vetvete. Më shumë decentralizim ndër institucionet e saj si psh me njësitë administrative.

Bashkitë duhet të thellohen në transparencën e tyre vendim-marrëse me të gjitha mjetet e mundshme. Ato duhet të komunikojnë më shumë me qytetarët dhe të rrisin pjesëmarrjen reale. Politikat fiskale të jenë të orientuara nga nevoja e komunitetit më së shumti se sa nga nevoja për të rritur buxhetin e bashkisë. Investimet duhet të harmonizohen dhe balancohen ndërmjet zonave urbane dhe rurale pavarësisht ku ka më shumë qytetarë. Integrimi dhe kohezion urban

rural duhet të udheheqë punën në vazhdimësi të bashkive. Kujdes i madh duhet të bëhet me menaxhimin e burimeve njerëzore në bashki. Kjo e lidhur me dy dimensione, dimensionin sasior, numrin e punonjësve për të cilën ka tregues jo të mirë dhe bindës, dhe dimension profesional, që lidhet me kapacitetet e stafit që edhe këtu ka tregues jo të mirë, për shumë arsye që lidhen me pagën, largimet nga puna, dhe vendi në përgjithësi. Por rekomandojmë fort largimin e politikës nga punësimi dhe marrjes në punë nga afërsia politike.

Rimëkëmbja ekonomike e vendit kërkon bashkëpunim dhe sinergji mes dy pushteteve. Ekonomia lokale zhvillohet nga ekonomia qendrore, sikundër ekonomia qendrore zhvillohet nga ajo lokale. Pushtetet janë të ndarë por qëllimet janë të përbashkëta, sikundër nuk duhet të ndërhyjnë pa vend dhe në mënyrë jo ligjore në punët e njëri-tjetrit.

Edhe politikisht duhet kuptuar mirë koncepti se kur zgjedhjet janë qendrore, pushteti vendor duhet të rrijë larg dhe të jetë i moderuar, po kështu edhe kur zgjedhjet janë vendore qeveria duhet të rrijë larg, të mos ndikojë, se kështu promovon vlerat e konkurrencës dhe shpirtin dhe vullnetin lokal.

“30 qershori dhe bashkitë, nga tërmeti të COVID 19 por të shohim përpara”.

Metodologjia

Raporti pasqyron dhe analizon fotografimin e dinamikës së zhvillimit të pushtetit vendor në periudhën kohore që shtrihet brenda vitit 2020, por jo e shkëputur nga ngjarjet kohore të vitit 2019 dhe rekomandimet për vitin pasardhës 2021.

Raporti është përgatitur nga një grup pune, i përbërë nga ekspertë të pavarur dhe të Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë.

Raporti bazohet në analizimin e gjetjeve të identifikuar nga:

Veprimtaria e Shoqatës së Bashkive përgjatë periudhës që raportohet dhe nga historiku i eksperiencës së gjatë dhe profesionale që ka shoqata dhe stafi i saj në monitorimin e demokracisë dhe decentralizimit vendor, dhe reformave në administratë publike.

Raporti është hartuar në një terren të njohur, edhe nga pjesëmarrje aktive në takimet e Keshillit Konsultative pushtet qendror-pushtet vendor, ku strategji, ligje dhe udhëzime ishin temë diskutimi dhe opinionesh, pjesëmarrje në takime me institucionet qendrore, qasja e të cilave ka qenë shumë përfshirëse.

Opinionet dhe qëndrimet e Shoqatës mbi situatën aktuale dhe proceset përkatëse, mbi kuadrin ligjor në dinamikën e tij, konkluzionet dhe rekomandimet dalë nga takimet e forumeve teknike në fushat e veprimtarisë së qeverisjes vendore, opinione dhe rekomandime nga takimet rajonale me grupe interesi dhe stafet teknike dhe shoqëri civile.

Informacione nga burime të tjera nga bashkëpunimi dhe zbatimi i projekte, donatorë, ekspertë e partnerë të Shoqatës së Bashkive.

Hulumtime të raporteve, botimeve apo artikujve të ndryshëm të përgatitur si pjesë e qendrimeve, projekteve apo e veprimtarisë së institucioneve të ndryshme publike që veprojnë në fushën e pushtetit vendor.

Rezultate krahasimore të performancës së pushtetit vendor mes Shqipërisë dhe vendeve të tjera të rajonit të Europës Juglindore, të mundësuar nga NALAS (Rrjeti i Shoqatave të Autoriteteve Vendore për Europën Juglindore), ku Shoqata e Bashkive është anëtare aktualisht.

Performanca Buxhetore e Njësive të Qeverisjes Vendore për vitin 2020


Ecuria e zbatimit të buxhetit të Njësive të Qeverisjes Vendore (NJQV) përgjatë vitit 2020 është kushtëzuar së tepërmi nga efektet e dy fatkeqësitë natyrore që goditën vendin tonë në mënyrë të njëpasnjëshme gjatë fundit të vitit 2019 (Tërmeti i 26 Nëntorit 2019) dhe fillimit të vitit 2020 (Pandemia COVID-19). Ndërhyrjet në buxhetin e vitit 2020 nëpërmjet 4 (katër) akteve normative të buxhetit 2020 të miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë, dhanë sinjalet e para se buxhetet e NJQV parashikoheshin me rënie në krahun e të ardhurave dhe rrjedhimisht në atë të shpenzimeve.

Tabela 1

Emërtimi	2019 Fakt	2020 Fillestar	2020 i rishikuar	2020 Fakt	Ndryshimi 2020 fillestar vs. 2020 fakt (në %)	Krahasimi 2020 fakt vs. 2019 fakt (në %)
Te ardhurat tatimore vendore	23,102	26,944	23,045	21,975	81.6%	-4.9%
Shpenzimet vendore (total)	56,227	57,554	53,285	51,626	89.7%	-8.2%

Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë*, www.financa.gov.al

Siç evidentohet qartë në Tabelën 1, buxheti i Njësive të Qeverisjes Vendore pësoi një rënie në nivelin e të ardhurave të pritshme nga taksat me rreth 3.9 miliardë lekë më pak për vitin 2020. Gjithsesi ky nivel i pritshëm nuk u arrit, pasi niveli faktik i të ardhurave tatimore vendore regjistroi rreth 22 miliardë lekë, ose 1 miliardë lekë më pak se i plani i rishikuar për këtë periudhë. Niveli i realizimit në raport me parashikimet fillestare për vitin 2020 është në masën 81.6% ndërkohë që krahasuar faktin e vitit 2019 kemi një rënie me 4.9%. Nga ana tjetër, shpenzimet vendore u rishikuan në ulje me 4.2 miliardë lekë, ndërkohë që shpenzimet vendore faktike e theksuan më tej këtë rënie duke shënuar rreth 6 miliardë lekë më pak se plani fillestar i vitit 2020. Gjithashtu, dhe krahasuar me vlerën e realizuar të vitit 2019, shikohet një rënie e theksuar e shpenzimeve vendore totale për vitin 2020 me rreth 8.2% më pak. Në vijim, do të prezantohet ecuria faktike e treguesve buxhetorë 2020 për NJQV duke ofruar dhe një krahasim me ecurinë e vitit të mëparshëm.



Të njëjtat të dhëna të Tabelës 1 paraqiten dhe në grafikun e mësipërm.

Burimet financiare

Burimet financiare totale të qeverisjes vendore deri në fund të vitit 2020 regjistruan një vlerë prej 52 miliardë lekë, në rritje të lehtë prej 0.2% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.


Tabela 2. Burime financiare të NJQV sipas kategorive (në lekë)

	2019 Fakt	2020 Fakt	Diferenca	
			(absolute)	(ne %)
Të ardhurat e veta	25,560,822,145	24,193,380,087	-1,367,442,058	-5.3%
Transferta e Pakushtëzuar dhe Specifike	24,663,762,864	25,559,999,936	896,237,072	3.6%
Taksat e Ndara	1,675,112,103	2,263,355,534	588,243,431	35.1%
Totali	51,899,697,112	52,016,735,558	117,038,445	0.2%

Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Portali i Financave Vendore*
www.financatvendore.al

Sikurse evidentohet nga Tabela 2, të ardhurat nga burimet e veta kanë pësuar një rënie të ndjeshme me rreth 1.4 miliardë lekë më pak se e njëjta periudhë e vitit 2019 ose 5.3% më pak. Ndërkohë që transferta e pakushtëzuar dhe specifike ka pësuar një rritje përgjatë kësaj periudhe, duke shënuar një rritje prej 896 milionë lekë ose rreth 3.6% më shumë se viti 2019.

Diferenca në % e burimeve financiare të NJQV sipas kategorive



Ndërkohë që të ardhurat nga taksat e ndara u rritën me rreth 35.1% më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019.

Ecuria e të ardhurave nga burimet e veta vendore sipas NJQV

Të ardhurat nga burimet e veta vendore (taksa dhe tarifa vendore, veprimtari me asete dhe të tjera) regjistruan një vlerë prej rreth 24.2 miliardë lekë, me një zvogëlim prej rreth 5.3% në terma vjetorë, ose rreth 1.4 miliardë lekë më pak nga niveli i regjistruar në vitin e mëparshëm.

Sipas kategorive përbërëse, performanca negative e të ardhurave nga burime të veta është përcaktuar kryesisht nga kontributi i të ardhurave nga taksat (-5%) dhe tarifat (-6.6%) vendore në këtë periudhë.

Tabela 3. Të ardhurat nga burimet e veta sipas kategorive (në lekë)


	2019 Fakt	2020 Fakt	Diferenca	
			(absolute)	(ne %)
Te ardhura nga taksat vendore	15,802,637,353	15,019,737,275	-782,900,078	-5.0%
Tarifa vendore	9,475,325,582	8,846,583,458	-628,742,124	-6.6%
Të tjera	282,859,210	327,059,354	44,200,144	15.6%
Totali	25,560,822,145	24,193,380,087	-1,367,442,058	-5.3%

Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Portali i Financave Vendore*
www.financatvendore.al

Grafiku më poshtë jep diferencat në të ardhurat prej taksave, tarifave dhe të ardhurave të tjera për vitin 2020 duke e krahasuar me vitin 2019. 30 nga 61 bashki, kanë arritur që të kenë një performancë pozitive të të ardhurave për këtë periudhë, por që nuk kanë mundur


të neutralizojnë rënien e të ardhurave nga burimet e veta 31 NJQV të mbetura. Disa nga bashkitë e prekura nga tërmeti i 26 Nëntorit 2019, shfaqin rënie të theksuar të të ardhurave, si Bashkia Durrës, Krujë, Kurbin e Shijak. Nga ana tjetër, vlen për t'u përmendur performanca pozitive e Bashkive Sarandë, Himarë e Pogradec, e cila mund t'i atribuohet dhe lehtësimit të masave kufizuese prej pandemisë gjatë sezonit veror 2020, duke qënë së këto bashki janë destinacione turistike.

Diferenca në % e të ardhurave nga burimet e veta sipas kategorive



Të dhënat për secilën bashki janë si shtojcë e këtij raporti në Tabelën 4. Diferencat në vlerë absolute të të ardhurave nga burimet e veta vendore në nivel bashkie (në lekë).

Krahasimi me 2019 i të ardhurave vendore



Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Portali i Financave Vendore*
www.financatvendore.al

Shpenzimet e Njësive të Qeverisjes Vendore

Në kahun e shpenzimeve të kryera nëpërmjet burimet e veta, performanca e 61 bashkive në total për vitin 2020 në vlerën 51.3 miliardë lekë vijon llogjikshëm trendin rënës krahasuar me një vit më parë ku në vlerë absolute kemi një diferencë negative prej 4.5 miliardë lekë, ose 8.1% më pak se e njëjta periudhë e vitit 2019.

Tabela 5. Shpenzimet e NJQV nga burimet e veta (në lekë)

	2019 Fakt	2020 Fakt	Diferenca	
			(absolute)	(ne %)
Shpenzime nga burimet e veta	55,859,721,125	51,307,466,420	-4,552,254,704	-8.1%
Totali	55,859,721,125	51,307,466,420	-4,552,254,704	-8.1%

Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Portali i Financave Vendore*
www.financatvendore.al


Ecuria e shpenzimeve sipas Njësive të Qeverisjes Vendore

Nga analizimi i të dhënave për shpenzimet totale të kryera nga 61 bashkitë në vitin 2020 (krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019), konstatohet një performancë që varion nga bashkia në bashki (Tabela 6) dhe nuk ndjek të njëjtin trend si në rastin e të ardhurave nga burimet e veta të analizuar më lart. 38 nga 61 Bashki kanë shpenzuar më pak në vitin 2020 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Thuajse të gjitha bashkitë e cilësuara si të mëdha shfaqin trend rënës, ku spikasin Bashkia Tiranë (-1.2 miliardë lekë), Bashkia Durrës (-458.2 milionë lekë) dhe Bashkia Lezhë (-330.2 milionë lekë). Vlen për t'u theksuar fakti se shumica dërrmuese e Bashkive

¹ Këtu përfshihen të ardhurat nga taksat dhe tarifat, taksat e ndara dhe transfertat e pakushtëzuar dhe specifike

të prekura nga tërmeti i 26 Nëntorit 2019, shfaqin shpenzime në rënie krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Diferenca e shpenzimeve nga burimet e veta nga viti 2019 në vitin 2020



Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Portali i Financave Vendore*
www.financatvendore.al


Të dhënat e detajuara për secilën bashki janë shtojcë e këtij raporti: Tabela 6. Diferencat në vlerë absolute të shpenzimeve totale vendore në nivel bashkie (në lekë).

Detyrimet e prapambetura të NJQV

Nga të dhënat e publikuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, vërehet se në fund të vitit 2020, totali i detyrimeve të prapambetura të NJQV arrin 6.930 miliardë lekë, duke shënuar njëkohësisht një ulje të konsiderueshme prej 1.239 miliardë lekë krahasuar me vitin e kaluar.


Duhet theksuar se borxhi në total i bashkive për vitin 2020 ka një shpërndarje jo propocionale. Borxhi më i lartë është akumuluar nga 3 bashki, Tirana, (761.8 mln) Kavaja (727.8 mln) dhe Vora (702.6 mln) ku secila prej tyre mban më shumë se 10% të borxhit total vendor. Ky grup pasohet nga tre bashki të tjera, Pogradeci (338.7 mln), Lezha (308.4 mln) dhe Roskoveci (302.2 mln), të cilat kanë secila afro 5% të borxhit total vendor.

Gjithsesi, performanca e 61 bashkive në këtë aspekt është mikse, ku referuar të dhënave të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë vërehet se 16 prej 61 bashkive e kanë shtuar vlerën e detyrimeve të prapambetura ku spikasjin Bashkia Vorë (+687.9 milionë lekë), Bashkia Malësi e Madhe (+204.4 milionë lekë), Bashkia Roskovec (+156.8 milionë lekë), Bashkia Belsh (+87.8 milionë lekë), Bashkia Divjakë (+62.7 milionë lekë) dhe Bashkia Kuçovë (+92.2 milionë lekë). Nga ana tjetër, vërehet një ecuri tejet pozitive në shlyerjen e detyrimeve të prapambetura nga Bashkia Tiranë (-996.1 miliardë lekë), Bashkia Kukës (-206.1 milionë lekë), Bashkia Kamëz (-143 milionë lekë), dhe Bashkia Bulqizë (-121.9 milionë lekë). Vlen për t'u theksuar se Bashkia Patos, Bashkia Këlcyrë dhe ajo Devoll nuk kanë detyrime në fund të vitit 2020.



Borxhi është i shpërndarë në disa kategori shpenzimesh, ku investimet janë barra kryesore më 53.4% pasuar nga të tjera me 17%, vendimet gjyqësore me 11.5% dhe shërbimet me 10%.

Stoku i detyrimeve të 2020 në vlera sipas kategorive




Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë, www.financa.gov.al*

Të dhënat e detajuara për borxhin paraqiten si shtojcë e këtij raporti në dy tabela. Tabela e parë paraqet detyrimet e prapambetura të NJQV, përfshirë dhe qarqet për periudhën 2019-2020 (në milionë lekë), ndërsa tabela e dytë paraqet borxhin vetëm për bashkitë.

Numri i punonjësve të NJQV

Gjatë vitit 2020, sipas sistemit informatik financiar të Qeverisë (SIFQ), numri total i punonjësve faktikë për 61 njësitë e qeverisjes vendore rezultoi 34,047 punonjës. Krahasuar me vitin 2019, evidentohet një rritje me 901 punonjës më shumë. 40 nga 61 bashki të marra në analizë, sikurse vërehet në grafikun më poshtë, kanë shtuar numrin e punonjësve krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ku spikasin veçanërisht Bashkia Tiranë (+488 punonjës), Bashkia Pogradec (+130 punonjës) dhe Bashkia Durrës (+81 punonjës). Nga ana tjetër, vërehen bashki që kanë një trend në zbritje të numrit të punonjësve, ku veçohen Bashkia Dibër (-63 punonjës), 19 Bashkia Kamëz (-53 punonjës) dhe Bashkia Lezhë (-52 punonjës) dhe 2 bashki të cilat nuk e kanë ndryshuar numrin e punonjësve.

Krahasimi me 2019 i nr. të punonjësve



Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë, www.financa.gov.al*

Tabela më të dhënat për secilën bashki është shtojcë e këtij raporti si Tabela 8. Numri i punonjësve të NJQV për periudhën 2019-2020.

Stresi financiar i bashkive

Ligji 68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore” prezantoi konceptin e vështirësive dhe stresit financiar të bashkive, vështirësi të cilat u kategorizuan në 4 faza. Situata financiare e bashkive vlerësohet në raportin në përqindje të detyrimeve të prapambetura të bashkisë kundrejt shpenzimeve vjetore të miratuara. Ligjin parashikon që bashkitë që kanë detyrime të konsiderueshme financiare të pashlyera të hartojnë plane rehabilitimi financiar. Gjithashtu kërkon që Ministria e Financave dhe Ekonomisë të monitorojë këto plane dhe të marrë masa nëse këto plane dështojnë në përmirësimin e situatës.

Më konkretisht, rastet e vështirësive financiare të bashkive shpjegohen më poshtë.

Kategoria 1: Bashkia konsiderohet se ka **probleme financiare** kur detyrimet e konstatuara të papaguara përbëjnë **15 - 25 % të shpenzimeve vjetore** të aprovuara.

- Kategoria 2: Bashkia është në **vështirësi financiare** kur vonesat në likuidimin e detyrimeve konstatohen edhe në muajin pasues të muajit dhe vlera e stokut të detyrimeve rritet progresivisht mbi nivelin prej **25% të shpenzimeve vjetore** të miratuara.
- Kategoria 3: Bashkia është në **vështirësi serioze financiare** kur borxhet afat-gjata dhe detyrimet e papaguara përbëjnë mbi **80% të shpenzimeve vjetore**. Në këtë fazë parashikohet ndërhyrja e Ministrisë së Financave dhe Këshillit të Ministrave.
- Kategoria 4: Bashkia është në **paaftësi paguese** kur raporti i borxheve afatgjata dhe detyrimeve të papaguara ndaj buxhetit të miratuar është më i lartë se **1:3**. Ministria e Financave propozon vendosjen nën administrim të njësisë përkatëse vendore.

Vlerësimi i situatës financiare të bashkive është kryer së fundmi në vitin 2019 nga Projekti “Financat Lokale”, i mbështetur nga Qeveria Zvicerane/SECO. Sipas këtij raporti për vitin 2019 kemi një bashki me status në “vështirësi serioze financiare” me stok të detyrimeve të prapambetura të barabartë me 85.2% të shpenzimeve të miratuara. 9 bashki gjenden në situatën “vështirësi financiare” (Konispol, Ura Vajgurore, Kukës, Rrogozhinë, Poliçan, Dibër, Pogradec, Finiq, Tepelenë), 12 njësi kanë probleme financiare dhe 37 bashki nuk kanë probleme financiare.

Gjatë 2019, bashkitë e Shkodrës, Korçës, Fierit, Elbasanit, Durrësit e Tiranës kanë një performancë shumë të mirë me stok njëshifror të detyrimeve të prapambetura përkundrejt shpenzimeve të miratuara.

Nr.	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore	Përqindja e stokut ndaj shpenzimeve të miratuara	Statusi i Vështirësisë
39	Të gjitha bashkitë që nuk përmenden më poshtë	< 15 %	Pa probleme financiare
12	Peqin (PQN)	14.91%	Probleme financiare
	Lezhë (LZH)	17.26%	
	Klos (KLS)	18.27%	
	Selenicë (SLN)	18.42%	
	Mirditë (MRD)	19.25%	
	Kamëz (KMZ)	19.97%	
	Cërrik (CRRK)	21.01%	
	Librazhd (LBR)	21.12%	
	Roskovec (RSK)	21.53%	
	Libohovë (LBH)	23.30%	
	Bulqizë (BLQ)	23.49%	
Tropojë (TRP)	24.44%		
9	Tepelenë (TPL)	31.81%	Vështirësi financiare
	Finiq (FNQ)	32.79%	
	Pogradec (PGR)	35.89%	
	Dibër (DBR)	37.04%	
	Poliçan (PLC)	41.94%	
	Rrogozhinë (RRGZH)	43.34%	
	Kukës (KKS)	44.13%	
	Ura Vajgurore (URV)	45.82%	
	Konispol (KNS)	58.76%	
1	Kavajë (KVJ)	85.20%	Vështirësi serioze financiare

*Tabela tregon grupin e 22 bashkive lidhur
me statusin e vështirësive financiare*

Bashkitë duhet të punojnë ende drejt përmirësimit të disiplinës financiare për të shmugur grumbullimin e detyrimeve të prapambetura në nivel vendor. Ato duhet të përmirësojnë gjithashtë aftësitë dhe kapacitetet për të monitoruar dhe vlerësuar zbatimin e buxhetit. Kryetari i bashkisë por dhe vetë këshilli duhet të kenë një rol më aktiv në këtë monitorim.

Legjislacioni që prek qeveritë lokale dhe këndvështrimi i ShBSh

Aktet ligjore me ndikim në fushën e qeverisjes vendore të miratuara gjatë vitit 2020 kanë qenë relativisht të pakta krahasuar me vitet e shkuara. Kjo për arsyen kryesore se vëmendja dhe e pushtetit legjislativ i është përkushtuar përballimit të situatës COVID 19 dhe pasojave të tërmetit të nëntorit 2019. Megjithatë, më poshtë po paraqesim një përmbledhje të akteve më të rëndësishme së bashku me ndryshimet thelbësore që ato sjellin, parë nga këndvështrimi i bashkive.

Ligji 20/2020 “Për Përfundimin e Proçeseve Kalimtare të Pronësisë” u miratua në datë 5 mars 2020. Qëllimi i tij është krijimi i një baze ligjore të thjeshtuar dhe të harmonizuar për përfundimin e proçeseve kalimtare të proçedurave të regjistrimit të pronave të paluajtshme të shtetit dhe private.

Risite kryesore të këtij Ligji mund të përmbliidhen si më poshtë:

- **Titujt e pronësisë mbi Tokën Bujqësore:** Ligji 20/2020 parashikon se Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi (“AMTP”) i fituar para hyrjes në fuqi të këtij ligji nuk do t’i nënshtrohet verifikimit të vlefshmërisë nga ASHK dhe do të regjistrohet në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme, nëse plotësohen kriteret e paracaktuara në ligj.

- **Ndërtimet pa leje, objektet pa titull pronësie dhe oborret në përdorim:** Risia konsiston në faktin që vlera e këtyre ndërtimeve të cilat nuk legalizohen do të regjistrohet gjithsesi në bazën e të dhënave për efekt njohje, sipas procedurave të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.
- **Përditësimi, inventarizimi, transferimi dhe regjistrimi i pronave të paluajtshme publike** saktësohet sipas procedura të parashikuara sipas listës përfundimtare të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Miratimi i këtij ligji solli shfuqizimin e Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, aq shumë të debatuar për zbatimin dhe pasojat që ai ka prodhuar.

Ligj 122/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar solli përjashtimin nga tatimi mbi fitimin për bizneset e vogla. Më konkretisht ndryshimi parashikon se “shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 8 (tetë) milionë lekë, është 0 (zero).” Duke qenë një e ardhur vendore, Shoqata e Bashkive ka kërkuar rimbursimin rigoroz të të ardhurave të munguara si pasojë e këtij ndryshimi ligjor. Nga ana tjetër, nisma është konsideruar pozitive si përkrahje e bizneseve të vogla në këtë kohë pandemie.

Ligji Nr. 98/2020 “Për një ndryshim në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar u miratua në datë 23.07.2020 dhe u botua në Fletoren Zyrtare nr.145, dt.06.08.2020. Ky ndryshim hoqi pengesën e paraqitjes së një dokumenti për shlyerjen e taksave vendore nga aplikuesit për leje legalizimi. Ndryshimi ishte si vijon:

“Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0.5 (zero pikë pesë) për qind e vlerës së investimit. Leja e legalizimit lëshohet vetëm pasi të jetë vërtetuar pagesa e taksës nga taksapaguesi”.

Ligji 101/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar u miratua pas një procesi të gjatë negociimi kryer nga Komisioni i ngritur për reformën elektorale në tetor. Përsa i përket ndryshimeve që prektin pushtetin vendor ato lidhen me ndryshimin e periudhës zgjedhore, detyrimin për raportim të veprimtarisë publike në prag zgjedhjesh dhe detyrimi për respektimin e përfaqësimit gjinor. Më konkretisht:

- Zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin apo për njësitë e qeverisjes vendore zhvillohen njëherësh në të gjithë territorin e vendit brenda periudhës që shtrihet nga 15 prilli deri në 15 maj ose nga 15 tetori deri në 15 nëntor.
- Institucionet publike janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.
- Për çdo zonë zgjedhore në zgjedhjet për Kuvendin jo më pak se një në çdo tre emra të listës shumëmemërore duhet t'i përkasë gjinisë së nënpërfaqësuar, kurse në zgjedhjet për këshillat bashkiakë një në çdo dy emra të njëpasnjëshëm në renditje duhet t'i përkasë së njëjtës gjini. Mospërbushja nga subjekti zgjedhor i detyrimit të parashikuar në këtë ligjpassjell refuzimin e listës shumëmemërore për t'u regjistruar në KQZ ose, sipas rastit, për zgjedhjet vendore në KZAZ.

Ligj 102/2020 “Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin” ishte mjaft i debatuar në arenën mediatike veçanërisht pas miratimit të tij. Ai synon të përcaktojë instrumente për zhvillimin rajonal dhe kohezionin në Republikën e Shqipërisë, duke siguruar nxitjen e zhvillimit të balancuar ekonomik, shoqëror e kulturor rajonal, të sigurojë që autoritetet politikëbërëse të bashkërendojnë veprimtaritë e tyre planifikuese për të nxitur planifikimin e harmonizuar e të integruar të rajoneve, të sigurojë harmonizimin e strategjive sektoriale në një politikë të përbashkët zhvillimore rajonale, duke e mbështetur atë edhe me buxhetin përkatës. Për qëllime të këtij ligji, Shqipëria ndahet në 4 rajone për tu përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Parimisht, zhvillimi rajonal është i domosdoshëm, por është mirë të realizohet nëpërmjet institucioneve të zgjedhura vendore duke reformuar kryesisht nivelin e dytë të pushtetit vendor. Në fazën e konsultimit në kemi sugjeruar se rajonet dhe kufijtë e tyre duhet të përcaktohen me një proces të gjerë komunikimi dhe konsultimi, nga poshtë lart me konsensus të gjerë politik dhe jo thjesht me një VKM. Një vend i vogël si Shqipëria veçanërisht pas reformës territoriale e cila krijoi 61 bashki, nuk ka më aspak nevojë të bëjë politikë qendrore të përqendruar, por politika lokale dhe rajonale, nga institucione të zgjedhura.

Rekomandimi ynë vazhdon të jetë se qeveria duhet të përdorë politikën e reformimit të 12 qarqeve aktuale, për të siguruar zhvillimin rajonal dhe jo të krijimit të strukturave të reja të mbivendosura me ato aktuale.

Ligj 71/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.10 465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar mundësoi nisjen e zbatimit të reformës së shërbimit veterinar dhe plotësimi i kuadrit ligjor për unifikimin e shërbimit veterinar, duke mundësuar kalimin e kompetencave e të funksioneve të shërbimit veterinar të vetëqeverisjes vendore

në strukturën e shërbimit veterinar në Ministrinë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Me miratimin e ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", njësitë e qeverisjes vendore nuk kanë më funksione lidhur me shërbimin veterinar apo struktura veterinare. Kjo dispozitë e vendos autoritetin kompetent në varësi të Ministrit dhe përcakton që në ministri organizohet një strukturë përgjegjëse për veterinarinë, e cila mbulon shërbimin veterinar. Kjo strukturë do të organizohet në nivel rajonal.

Bashkëpunimi i njësite të vetëqeverisjes vendore dhe shërbimit veterinar lidhet me zbatimin e masave profilaktike, funksionimin e tregjeve të kafshëve të gjalla dhe kullotave, kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve infektive në kafshë, kontrollin e qenve dhe maceve të rrugës, kontrollin në ambientet publike për vendosjen e maskës mbrojtëse të kafshët agresive të shoqërimit dhe përcaktohet vendgroposja dhe eliminimi i kadavrave të kafshëve, rrethimi dhe ruajtja e pikave të grumbullimit të mbetjeve.

Ligj 57/2020 "Për pyjet" rregullon përcaktimin e rolit dhe të përgjegjësive funksionale për të gjitha institucionet përgjegjëse për pyjet, në nivel qendror dhe vendor, tashmë edhe me ngritjen e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve. Ligji i ri për pyjet u konsiderua një domosdoshmëri për tju përshtatur dhe ndarjes së re territoriale me 61 bashki.

Roli i bashkive nis me sigurimin e buxhetit në financimin të sektorit të pyjeve së bashku me buxhetin e shtetit, donacionet dhe të ardhurat nga të gjitha aktivitetet e mundshme në fondin pyjor. Risia e këtij ligji për pushtetin vendor qëndron te strukturat komunitare në fshat (kryetari i fshatit dhe kryesia e fshatit) që kujdesen për përdorimin e qëndrueshëm të pyjeve në fshat në përputhje me nevojat dhe politikat për zhvillimin e zonave rurale.

Ligji vendos standarte përsa i përket burimeve njerëzore. Numri i punonjësve të strukturës përgjegjëse për pyjet përcaktohet në përpjesëtim me sipërfaqen e fondit pyjor si më poshtë:

- a) një specialist pyjesh për 750 – 1000 ha për pyjet e larta;
- b) një specialist pyjesh për 1500 – 2500 ha për pyjet e ulëta dhe shkurret.

Ligj Nr. 106/2020, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar parashikon një ndryshim në prapen e tatimit mbi fitimin. Më konkretisht, shkalla tatimore ndryshohet në

- a) 0% për tatimpaguesit me të ardhura deri në 14 000 000 lekë në vit.
- b) 15% për tatimpaguesit me të ardhura mbi 14 000 000 lekë në vit.”.

VKM Nr.684, datë 02.09.2020 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike”, bën një rregullim në përputhje me ndryshimet administrative-territoriale. Ai parashikon se sipërfaqet e fondit pyjor dhe kullësor publik, sipas listave të inventarit, infrastruktura mbështetëse e tyre, asetet, arkivi dhe protokollit, aktualisht, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mjedisit, si edhe sipërfaqet e fondit pyjor e kullësor publik dhe infrastruktura mbështetëse e tyre, që i janë transferuar ish- komunave e bashkive, transferohen në pronësi të bashkive.

Ligj 63/2020 “Për përmirësimin e zonave të biznesit (BID)” paraqet për herë të parë konceptin e BID-it në Shqipëri si “Business Improvement District - BID” ose “Zonë për Përmirësimin e Biznesit”.

Ky ligj ka për qëllim krijimin e një mekanizmi, me statusin e një organizate fitimprurëse, ku poseduesit e njësisve tregtare, të cilat përdoren për qëllime biznesi, të nxiten të marrin pjesë në procesin e zhvillimit të qëndrueshëm të zonës që sipas këtij ligji quhet “BID”, nëpërmjet kontributeve private, të cilat përdoren për shërbime shtesë për bizneset në zonën BID përkatëse.

Ne shohim një problematikë lidhur me rolin e bashkisë në funksionimin e organizatave BID. Kjo për dy arsye, së pari BID do të ndërhyjë me anë të “marrëveshjeve operacionale” në kryerjen e funksioneve publike të bashkisë kryesisht lidhur me investime në infrastrukturë dhe së dyti parashikimin e financimeve që kalohen nga bashkia përkatëse tek organizata BID, në përputhje me këtë ligj.

Nuk shohim dhe kuptojmë qartë nevojën për një parashikim ligjor të bashkëpunimit të bashkive me njësitë tregtare që operojnë në zona të caktuara. Kjo sepse ligji do të sillte një detyrim për bashkinë ndërkohë që bashkia mund të realizojë dhe formësojë bashkëpunime me operatorët privatë pa nevojën e një ligji. Shprehim rezervat tona të forta për dispozitat përkatëse dhe për zbatimin praktik të këtij ligji.

Vendim Nr. 144, datë 13.2.2020 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 132, datë 7.3.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme ‘ndërtesa’, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, të ndryshuar ka sjellë ndryshime në cmim për metër katror për ambiente të hapura Bashkinë Tiranë dhe në cmimin për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për veprimtari industrial në 50 (pesëdhjetë) % e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, sipas qyteteve ose sipas njësisve administrative për Bashkinë Tiranë.

Vendim Nr.405, datë 20.5.2020, “Për miratimin e strategjisë së zhvillimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor në Shqipëri 2020-2025” është hartuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale dhe miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Lidhur me detyrat e parashikuara për pushtetin vendor, Strategjia është shumë e përgjithshme pa përcaktuar as detyrime as burime financiare për bashkitë. Autoritetet e qeverisjes vendore do të duhet të zgjidhin përfundimisht aspektet legale të pronësisë mbi qendrat e kujdesit parësor, ç’ka do t’i hapë rrugën investimeve të mëtejshme në këto qendra nga pushteti lokal dhe partnerët e tij të mundshëm, përfshirë edhe sektorin privat. Më kokretisht, roli i pushtetit vendor parashikohet si më poshtë:

Vendim Nr. 418, datë 27.5.2020, “Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të Planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve, 2020–2035” i referohet vetëm në dy paragrafe impinateve të mbetjeve për energji, që kanë qenë objekt i debatit publik gjatë vitit 2020 për inceneratorët e Tiranës, Elbasanit dhe Fierit. Sipas strategjisë, impiantet e mbetjeve për energji janë pjesë e menaxhimit të mbetjeve, si opsioni i parafundit i hierarkisë. Pas ndjekjes së gjithë proceseve paraprake të grumbullimit të diferencuar, riciklimit, kompostimit, depozitimit të mbetjeve të ngurta, në përputhje me politikat në këtë dokument dhe skemat teknike të vendosura në Plani Kombëtar Sektorial për menaxhimin e mbetjeve të ngurta, bashkitë dhe prodhuesit e tjerë të mbetjeve mund t’i dërgojnë mbetjet e tjera të djegshme në këto impiante.

Ngritja e këtyre impianteve për djegjen e mbeturinave me iniciativë të Këshillit të Ministrave është një çënim i autonomisë së pushtetit vendor parashikuar në Kushtetutë, Kartën Europiane të Qeverisjes Vendore, Ligjit 139/2015 dhe legjislacionit mjedisor. Do të duhej të ishte iniciativa e bashkive, pas një analize të kostove dhe konsultimit publik që do duhej të çonte në një vendim të tillë.

Mbeten ende pikpyetje në funksionimin e inceneratorëve dhe detyrimeve të bashkive ndaj tyre. Cilat janë dhe si përcaktohen tarifat që bashkitë do të paguajnë? A do të ndikojnë ato në tarifat që do të paguajnë qytetarët dhe bizneset? A mund të detyrohen bashkitë rrethuese të dërgojnë mbetje në incinerator kur ato mund të gjejnë mënyra më rentabël të menaxhimit të mbetjeve?

Vendimi Nr. 456, datë 10.6.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 910, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për çështjet, objekt konsultimi, dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të këshillit konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar shton gamën e çështjeve për diskutim me çështjet lidhur me diasporën dhe migracionin, çka pason dhe ndryshime ligjore për krijimin e shërbimeve bashkiake për diasporën. Përfaqësimi i pushtetit qendror shtohet me përfaqësuesin e ministrit përgjegjës për marrëdhëniet me diasporën dhe përfaqësuesin e ministrit përgjegjës për mbrojtjen e sipërmarrjes. Vendimi bën dhe një rregullim në numrin e përfaqësuesve të pushtetit vendor për të kompensuar përfaqësimin e pushtetit vendor.

Vendim Nr. 783, datë 7.10.2020, “Për Miratimin e Planit të Veprimit 2020–2022, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2015–2020” është plani tre vjeçar që synon të çojë më tej decentralizimin në pushtetin vendor pas reformës territoriale.

Në pamje të parë, shumë prej objektivave duken të ezauruara dhe prej kontributit të projekteve të ndërmarra tashmë, veçanërisht Projektit STAR. Me këto objektiva kemi parasysh dixhitalizimin e arkivave, struktura e burimeve njerëzore etj. Jo të gjithë objektivat janë të buxhetuar dhe të përcaktuar në terma të përgjegjësive institucionale. Më poshtë, ne po rendisim disa objektiva që besojmë se do të kenë interesin e veçantë të bashkive.

1. Rritja e ndarjes së të ardhurave nga taksa e rentës minerare për njësitë e vetëqeverisjes vendore nga niveli aktual prej 5% në 8%.
2. Rritja graduale e financimit për transfertën e pakushtëzuar për të akomoduar financimin e funksioneve të reja të transferuara me ligjin për Vetëqeverisjen Vendore.
3. Hartimi i një studimi mbi funksionet vendore që financohen me transferta të kushtëzuara, nevojat e bashkive për financim në këto funksione dhe mundësitë e financimit me transferta të kushtëzuara të njësive të vetëqeverisjes vendore nga buxheti i shtetit.
4. Brenda politikave kombëtare makroekonomike e fiskale, në limitin vjetor të huamarrjes publike të përcaktohet një hapësirë e dedikuar për qeverisjen vendore.
5. Hartimi i kuadrit nënligjor për parandalimin dhe menaxhimin e problemeve dhe vështirësive financiare në nivel vendor.
6. Harmonizimi i kuadrit ligjor e rregullator për shërbimin e furnizimit me ujë dhe trajtimit të ujërave të ndotura (ligji për sektorin e ujit) dhe përcaktimi i standardit minimal të cilësisë dhe sigurisë së shërbimit të furnizimit me ujë dhe kostimi i tij.
7. Hartimi i studimeve të riorganizimit të mundshëm të SH.A. UK-ve për rritjen e efijensës.
8. Asistencë teknike për NJVV-të për zbatimin e VKM-së nr. 319, datë 31.5.2018, “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”.
9. Asistencë teknike për qartësimin dhe negocimin e marrëdhënieve kontraktuale të NJVV-ve me qeverinë qendrore dhe impiantet e trajtimit të mbetjeve 2020 2021.
10. Ndërtimi i impianteve të trajtimit të mbetjeve në përputhje me masterplanin kombëtar.

11. Ngritja dhe konsolidimi i skemës së financimit për kompetencat e NJVV-ve në fushën e shëndetësisë, përfshirë mirëmbajtjen e godinave shëndetësore.
12. Hartimi/përditësimi i standardeve minimale kombëtare për fushat prioritare:
 - Arsimi parauniversitar;
 - Shërbimet e pastrimit, gjelbërimit, etj.
 - Strehimit;
 - Sigurisë (Policia bashkiake);
 - Bujqësisë dhe zhvillimit rural;
 - Emergjencave Civile.
13. Ngritja e Fondit Kombëtar për nivelin vendor lidhur me projektet e BE-së.

Ligji 45/2019 për Mbrojtjen Civile dhe lehtësimi i pasojave të tërmetit dhe COVID 19

Funksionet e bashkive në fushën e sigurisë publike, siç janë përcaktuar në Ligjin Organik 139 të vitit 2015, ndër të tjera parashikojnë dhe përgjegjësitë e bashkive për mbrojtjen civile nga fatkeqësi natyrore ose të tjera.

Nga analizimi i legjislacionit aktual ne vumë re nevojën për një planifikim në nivel kombëtar të përmirësuar që do të krijonte mundësi për institucione më reaguese ndaj rrezikut natyror, për buxhetim më real dhe për një kordinim më të mirë në mbarë vendin. Ne identifikuam dhe paqartësi në ndarjen e roleve dhe përgjegjësiave mes institucioneve të ndryshme, kryesisht atyre qendrore dhe vendore. Sigurisht, nuk mund të mos përmendim mungesën e theksuar të mjeteve dhe infrastrukturës së nevojshme në bashki për përbalimin e fatkeqësive natyrore, jo vetëm në stacionet e zjarrfikseve, por dhe në mungesën e pikave të evakuimit, rezervave materiale etj.

Disa prej sfidave të konstatuara nga ne janë adresuar nga ligji i ri për mbrojtjen civile, miratuar në korrik të 2019. Ky ligj, i hap rrugë krijimit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, e cila, krahasuar me organizimin e mëparshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, do të ketë kapacitete më të mëdha administrative, teknike dhe financiare.

Ligji, në zbatim të parimit të subsidiaritetit, thekson rolin parësor dhe shumë të rëndësishëm të bashkive në zvogëlimin e riskut të fatkeqësive dhe mbrojtjen civile, që shoqërohet edhe me vendosjen e një kufiri minimal buxhetor të detyrueshëm për këtë qëllim. Bashkitë, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile mbështeten në parashikimin minimal prej 4 për qind të totalit të buxhetit vjetor të tyre, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit. Po sipas këtij parimi, ligji parashikon se në përballimin e një fatkeqësie natyrore fillimisht përdoren kapacitetet e njesisë së vetëqeverisjes vendore të prekur, nëse ato janë të pamjaftueshme, kërkohen kapacitete shtesë nga njësitë e vetëqeverisjes vendore fqinje. Nëse përsëri ka nevoja të mëtejshme, kërkohet angazhimi i kapaciteteve të tjera shtetërore, duke përfshirë Policinë e Shtetit dhe Forcat e Armatosura.

Po ashtu parashikohet dhe detyrimi i bashkive në kompensimin e dëmeve. Dëmet si rregull përballohen nga vetë bashkitë e prekura nga fatkeqësia nëpërmjet fondit të dedikuar për mbrojtjen civile dhe vetëm në rast se vlera e kompensimit tejkalon 8% të buxhetit të bashkisë, Komiteti i Mbrojtjes Civile mund të vendosë që kompensimi të kryhet nga Agjencia Kombëtare.

Vënia në zbatim e këtij ligji është sfida kryesore jo vetëm e bashkive por dhe institucioneve të tjera shtetërore. Pritshmëritë tona janë që të qartësohen rolet dhe përgjegjësitë, tashmë të rritura, të përmirësohet komunikimi midis të gjithë sektorëve dhe agjencive përkatëse me qëllim të nxitjes së një qasje të unifikuar ndaj masave që duhet të merren.

Po ashtu, ne shpresojmë të nisë një planifikim efikas financiar për të siguruar buxhetin e duhur në situata të tilla. Ky planifikim buxhetor i kujdeshëm do të mundësojë gradualisht dhe përmirësimin e infrastrukturës së nevojshme vendore.

Vendim datë 11.11.2020 “Për përcaktimin e rasteve dhe të mënyrës së bashkëpunimit, ndërmjet pushtetit qendror e njësive të vetëqeverisjes vendore, për krijimin ose shtimin e fondit publik të banesave sociale” rregullon mbështetjen financiare të njësisë vendore për fondin publik të banesave sociale.

Mbështetja financiare për krijimin ose shtimin e fondit publik të banesave sociale, sipas mënyrave të përcaktuara në pikën 1, të nenit 18, të ligjit nr.22/2018, “Për strehimin social”, i akordohet njësisë së vetëqeverisjes vendore nga ministria përgjegjëse për strehimin, brenda tavaneve buxhetore të miratuara çdo vit për strehimin dhe bazuar në nevojat e evidentuara në planet vendore 5- (pesë-) vjeçare të strehimit dhe mundësitë e bashkëfinancimit nga të ardhurat e veta të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Vendim Nr. 537, datë 8.7.2020 “Për miratimin e kërkesave minimale të performancës së energjisë së ndërtesave dhe të elementeve të ndërtesave” është i detyrueshëm për bashkitë si në monitorimin e lejeve të ndërtimit dhe në rikonstruksionin apo ndërtimin e ndërtesave publike.

Ky vendim përcakton kërkesat minimale të performancës së energjisë për të gjitha ndërtesat e reja dhe njësitë e ndërtesave të reja gjatë të gjitha fazave të ndërtimit, përfshirë projektimin si dhe për ndërtesat ekzistuese.

Vendim nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit

e të regjistrit qendror të personelit” parashikon që institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara të krijojnë e të administrojnë dosjen e personelit të çdo të punësuarit në institucionin e tyre.

Departamenti i Administratës Publike krijon dhe administron Regjistrin Qendror të Personelit (në vijim “RQP”), i cili është një bazë unike të dhënash shtetërore, ku ruhet e përpunohet elektronikisht informacioni për institucionin dhe burimet njerëzore aktive, për institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes.

Platforma e bashkëpunimit “administrata.al” është mjeti me anë të të cilit institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore raportojnë periodikisht të dhënat për llogaritjen e indikatorëve bazë të menaxhimit të burimeve njerëzore.

Thirrja e dytë për propozime në kuadër të funksionimit të Programit të Fondit Social monitoruar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, synon të mbështesë ngritjen e shërbimeve sociale në komunitet, të propozuara nga çdo njësi vendore/ bashki në Shqipëri. Fondi Social është krijuar në vitin 2018 dhe thirrja e parë është bërë gjatë nëntorit të 2019. Nisur nga numri i ulët i aplikimeve të bashkive në këtë Fond, ne kemi analizuar financimit e shërbimeve sociale dhe funksionimin e këtij Fondi.

Dhe pse ka pasur një rritje të transfertës së pakushtëzuar pas mbarimit të periudhës tranzitore tre vjeçare, kjo rritje, ashtu si dhe grantet e mëparshme specifike, nuk mundën të mbulojnë kostot shoqëruese për shërbimet sociale.

Kjo duket nga situata aktuale e ofrimit të shërbimeve sociale në bashki. Sipas raportit të Drejtorisë së Shërbimit Social për 2019, janë 21 bashki ose 30% të cilat nuk ofrojnë asnjë shërbim social.

Pushteti vendor, sfidat ndaj emergjencave nga tërmeti te pandemia e Covid 19

Bashkitë dhe tërmeti

Viti 2020 ishte një vit i vështirë për bashkitë në përgjithësi por veçanërisht për 11 bashkitë e prekura nga tërmeti. Vështirësi pati në kontekstin politik dhe socio – ekonomik.

Momenti na shfaq dy pamje: solidariteti lokal e ndërkombëtar dhe angazhimi qytetar nga njëra anë dhe nga ana tjetër një sistem i papregaditur për emergjenca civile, në nivel vendor dhe qendror, me mungesa të mëdha në kapacitete njerëzore, financiare, infrastrukturore dhe teknologjike.

Dëmet, ku kanë renduar ato më shumë?

- Tërmeti i 26 nëntorit 2019 dhe efektet e tij preken mbi 200 mijë persona;
- Efekti i përgjithshëm i katastrofës në 11 bashki arriti në 1 miliard euro (121.21 miliardë lekë), nga të cilat 843.9 milionë euro janë asete të shkatërruara fizike dhe 141.2 milionë euro janë humbje indirekte;
- Shumica e dëmeve janë regjistruar në sektorin e strehimit (78.5%), ndjekur nga sektori prodhues (8.4%) dhe sektori i edukimit (7.5%).

- Shumica e objekteve të dëmtuara rreth 76.5% kishin pronësi private dhe 23.5% publike. Sektorët e strehimit dhe prodhimit janë kryesisht infrastrukturë private, ndërsa sektorët e tjerë të mbetur kryesisht janë pronë publike.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të dëmeve dhe humbjeve, bashkia e **Durrësit** ishte më e prekura me 303.8 milion euro dëme ose 32.4% të dëmit dhe humbjeve totale, e ndjekur nga **Tirana** me 284.3 milion euro ose 30% e totalit, dhe së treti **Kruja** me 84.2 milion euro (1.04 miliardë lekë) ose 9%.

Donacionet, veçanërisht fondet e grumbulluara nga Konferenca e Donatorëve ishin një arritje që u pasua me një zbatim të ngadaltë.

Disbursimi i ngadaltë mund të shpjegohet pjesërisht me kohën që kërkojnë burokracitë e këtyre procedurave por dhe institucionet qendrore dhe ato vendore shqiptare duhet të punonin më shpejt dhe me më efikasitet.

Proçesi i rindërtimit të banesave dhe objekteve të tjera të shtetit dhe biznesit, të dëmtuara nga tërmeti i 26 nëntorit do të përfundojë deri në fund të vitit 2024 dhe do të kushtojë rreth 1 **miliardë euro**, shumë e cila do të financohet me 300 milionë euro nga burime të brendshme dhe pjesa tjetër nga donatorët dhe OJF-të. Mbi 800 milionë euro nevojiten vetëm për strehimin e banorëve.

Rindërtimi është planifikuar të kalojë në tre faza. Faza e parë është deri në fund të këtij viti dhe parashikohet të angazhojë investime deri në 545 milionë euro, ku mbi 90% e tyre do të shkojnë për rindërtimin e banesave.

Faza e dytë, në afatin e mesëm, 2021 dhe 2022, planifikon për tu investuar edhe 499,6 milionë euro ose 46.5 % e totalit, të cilat gjithashtu do t'i shërbejnë ndërtimit të banesave.

Faza e tretë, në afat të gjatë 2023-2024, do të angazhojë edhe 61 milionë euro, shumica e të cilave do të përdoren për rikuperim të infrastrukturës publike.

Por tani, pas një viti gjykojmë se është shumë e vështirë të arrihen objektivat e rindërtimit.

Dëmi sipas sektorëve tregon se kryesojnë banesat private. Përveç dëmeve në banesa, tërmeti i 26 nëntorit ka shkatërruar objekte **publike me ndikim të lartë social si shkolla, qendra shëndetësore dhe objekte të tjera publike.**

Objektet e dëmtuara janë si më poshtë:

- **Banesat, 11,490 duhen rindërtuar tërësisht, 83,745 riparuar;**
- **Arsimi, 321 objekte janë dëmtuar;**
- **Shëndetësia, 8% e objekteve janë dëmtuar;**
- **Infrastruktura publike, dëme 33 milionë euro;**
- **Sektori i biznesit, 714 sipërmarrje janë dëmtuar.**

Objekte të tjera publike të dëmtuara (57 ndërtesa në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, ndër të cilat një stacion zjarrfikës, dy ndërtesa të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, tetë stacione monitorimi nga Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit që u dëmtuan pak, gjashtë ndërtesa nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit u dëmtuan gjithashtu dhe shtatë objekte të tjera publike duhen riparuar. Dëmet në këto objekte u vlerësuan rreth 22 milionë euro.

Roli i Bashkive në rindërtim

Zbatimi i planit të rindërtimit është përqendruar te qeveria qendrore. Por një volum i madh pune është bërë nga bashkitë. Ato kanë bërë një punë të mirë me burimet e veta dhe pa mbështetje financiare nga qeveria për identifikimin, vlerësimin e dëmeve dhe mbështetjen për të prekurit.

Qeveria shqiptare miratoi në dhjetor 2019 Aktin Normativ për Njësitë Zbatuese **“Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”**.

Nga pikpamja administrative dhe ekzekutive proçesi i rindërtimit është tejet i centralizuar. Akti normativ cakton agjensi qeveritare si njësi zbatuese në tërësi. Bashkia Tiranë është e vetmja e përzgjedhur si njësi zbatuese nga 11 bashkitë e prekura nga tërmeti.

Mendimi i ShBSh është që bashkitë duhet të ishin njësi zbatuese së paku për ndërtesat e ulta individuale, ndërsa për ato kolektive të ishin njësi zbatuese ato që ka caktuar qeveria. Kjo do rriste besim të bashkitë, do kishim ndarje të përgjegjësive dhe të burimeve, si dhe konkurueshmëri më të madhe.

Bashkia dhe pandemia

Rastet e para të COVID-19 u identifikuan në fillim të marsit të vitit 2020, raste të cilat u pasuan menjëherë me mbylljen e institucioneve arsimore e më tej me mbylljen e gjithë vendit. Situata përgjatë muajve të mbetur të 2020 ka qenë vazhdimisht në zhvillim me luhatje të konsiderueshme. Pasojat e pandemisë vazhdojnë të sjellin efekte negative në të gjithë aspektet e jetës personale dhe publike. Humbjet e jetëve të shënuara nga pandemia janë ato me efektin më të rëndë pasuar nga humbjet ekonomike, efektet sociale veçanërisht tek fëmijët dhe të rinjtë etj.

COVID - 19 shtriu efektet e tij dhe në organizimin dhe funksionimin e organeve shtetërore duke qenë se ato kishin rolin parësor në përballimin e situatës dhe lehtësimit të pasojave. Efektet u ndjenë shumë dhe në pushtetin vendor, i cili duket se u gjet i papregatitur dhe pa mjete e nevojshme për t'ju përgjigjur situatës.

Kryesisht, emergjenca e COVID-19 është menaxhuar në nivel qendror duke anashkaluar dhe rolin që bashkitë kanë dhe ligjërisht në përballimin e situatave të tilla. Për vetë natyrën e tyre, bashkitë janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve për qytetarët dhe hallka e pushtetit më afër tyre. Rrjedhimisht, bashkitë duhet të kishin njohuritë mbi nevojat për emergjente dhe mjete për t'i adresuar ato.

Përveç sfidës për tju gjendur pranë qytetarëve, kryesisht atyre të moshës të tretë dhe me nevoja të veçanta, bashkitë u përballën dhe me vështirësi në funksionimin e tyre të brendshëm dhe në ofrimin e shërbimeve publike. Dhe kujtojmë këtu se nevoja për disa shërbime si pastrimi dhe dizinfektimi i ambienteve publike u shumëfishua.

Sfidat e pushtetit vendor mund të përmbliidhen në tre drejtime kryesore:

- Ofrimi i shërbimeve të lidhura me përballimin e pandemisë si pastrimi dhe dizinfektimi, mbikqyrja e rregullave të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë, shpërndarja e pakove ushqimore dhe ilaçeve për grupe të caktuara shoqërore në nevojë, pajisja me mjete dizinfektuese të institucioneve parashkollore dhe arsimore si dhe të qendrave shëndetësore, mobilizimi i fondeve të emergjencës dhe ngritja e grupeve vullnetare etj.
- Përballimi i kostos financiare të shërbimeve të sipërpërmendura dhe lehtësimi i pasojave ekonomike për qytetarët. Përgjithësisht, bashkitë aktivizuan fondin prej 4% të buxhetit të tyre alokuar për situata të emergjencës për të mbuluar shpenzime të domosdoshme për shkak të pandemisë. Nga ana tjetër, afro 1/3 e bashkive miratoi masa lehtësuese fiskale në uljen e tarifave dhe taksave ose në shtyrjen e afatit të pagesës së detyrimeve vendore për qytetarët dhe bizneset. Si rritja e shpenzimeve ashtu dhe ulja e të ardhurave do të kenë efektet e tyre në buxhetet vendore në një afat të gjatë, veçanërisht pasi bashkitë nuk patën transferta të dedikuara nga buxheti i shtetit për pandeminë.
- Funksionimi në vazhdimësi i bashkive ishte një problematikë që u qartësua pas muajve të parë të emergjencës kur dhe u kuptua që situata do të ishte më afatgjatë se ç'u mendua fillimisht. Gradualisht bashkitë filluan të ndër marrin kryesisht dy masa, së pari transferimi online i shërbimeve dhe së dyti

alternimi i punës së zyrë. Puna online u shtri në shërbimet e përshtatshme dhe në organizimin e mbledhjeve të këshillave bashkiakë. Shumë bashki vunë në dispozicion për qytetarët numra kontakti për shërbime specifike. Për pjesën tjetër të shërbimeve që kërkonin praninë fizike të punonjësve u morrën masa për të punuar në turne apo me grafikë të përshtatur sipas nevojave.

Shërbimet e prekura më shumë nga pandemia dhe rregullat mbrojtëse ishin gjendja civile, marrëdhëniet me publikun, tarifat dhe taksat vendore, aktivitetet kulturore dhe sportive dhe transporti publik.

Në një kuadër të përgjithshëm, sistemi shëndetësor u gjet para vështirësive të mëdha si pasojë e mungesës së kapaciteteve teknike dhe njerëzore. Hapja e pavionëve COVID në spitalet rajonale u krye me shumë vonesë duke përqendruar ngarkesën e infektiveve në spitale kombëtare. Roli i mjekut të familjes nisi të vlerësohej po me vonesë.

Përsa i përket ndihmës financiare nga ana e shtetit, Fondi Monetar Ndërkombëtar, në raportin¹ e muajit janar 2021, mbi nivelin e mbështetjes fiskale të drejtpërdrejtë për pandeminë, e rendit Shqipërinë të fundit në rajon. Niveli i mbështetjes buxhetore rezulton rreth 4.5 herë më pak se mesatarja e vendeve të rajonit.

Shqipëria ka mbetur në nivelin 1.2% të Prodhimit të Brendshëm Bruto sa i përket mbështetjes kundër COVID-19, ndërkohë Maqedonia e Veriut ndodhet në nivelin 2.6% të PBB, Bosnjë-Hercegovina në 5.1% të PBB, Kosova 5.6% e PBB, Serbia 5.6% e PBB dhe Mali i Zi në 8% të PBB.

Të dyja paketat fiskale të qeverisë ishin shumë të debatuar si për nga volumi i vogël financiar dhe për nga burokracitë për përfituesit. Biznesi në përgjithësi e ai i turizmit në veçanti kanë shprehur shumë

¹ <https://www.imf.org>

herë pakënaqësi për mungesën e konsultimit dhe masave konkrete e efikase nga ana e qeverisë. Rekomandime të shumta janë bërë për qeverinë që të shkurtojë pagesat për PPP-të dhe të shtojë mbështetjen buxhetore për përballimin e pasojave të pandemisë.

Asgjë nuk ka më shumë vlerë se shëndeti dhe jeta e qytetarëve, që duhet të jenë prioriteti ynë absolut!

Nga dimensionin politik lidhur me pandeminë, sfidat kanë qenë mungesa e autonomisë së pushtetit vendor, politizimi i emergjencave, kufizimet e qytetarëve në proceset vendimarrëse, niveli i ulët i besimit të institucionet qendrore por dhe vendore, stabiliteti i ulët politik dhe niveli i lartë i konfliktualitetit, interes i ulët i vëmendjes publike për çështjet lokale.

Por sfidat kanë qenë më të dukshme në dimensionin administrativ, ku vihej re dukshëm buxheti i pamjaftueshëm për shërbimet publike, pasiguria për fonde, vështirësi për bashkëpunim dhe koordinim vertikal dhe horizontal, kompleksiteti i situatës me shumë të panjohura, burokracitë dhe mungesë fleksibiliteti, mungese kapacitetesh, mungesë aksesit për informacione të besueshme, si dhe aftësi të kufizuara dhe mungesë eksperiencash në menaxhim pandemish. COVID-19 nuk luftohet me propaganda, gjithashtu nuk duhet të shfrytëzohet politikisht.

Këshilli konsultativ dhe ndërveprimi institucional

Këshilli Konsultativ Qeverisje Qëndrore - Qeverisjes Vendore 2020

Gjatë vitit 2020 Këshilli Konsultativ ka qenë shumë dinamik dhe përfshirës. Këshilli Konsultativ është forumi konsultues ndërmjet Qeverisë Qendrore dhe Vetëqeverisjes Vendore. Ky forum u krijua me Nr. 910, datë 21.12.2016, “Për çështjet, objekt konsultimi, dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të këshillit konsultativ të qeverisjes qëndrore me vetëqeverisjen vendore”, me qëllim institucionalizimin e procesit të konsultimit midis vetëqeverisjes vendore dhe asaj qëndrore.

Në vitin e katërt të funksionimit ky forum ka konsoliduar një praktikë konsultimi e cila gjithsesi mbetet një modalitet për t’u vlerësuar në terma efikasiteti si instrument ezaurues për adresimin e çështjeve të qeverisjes vendore. Kjo për arsye se ky këshill duhet të funksionojë sipas ligjit, i cili përcakton takimin mes dy palëve, pushtet vendor dhe pushtet qendror dhe në formatin e një konference, ku më shumë merr vëmendje vizibiliteti se sa qëllimi i vërtetë.

Objektimi i këshillit konsultativ është konsultimi dhe dakordësimi për çështje me interes për të dy pushtetet. Ky objekt është zhvendosur në një takim linear dhe shumë tema dhe çështje në një numër të madh, dhe me shumë aktorë nga më kryesorët te më periferikët. Kjo qasje e dobëson shumë këtë institucion.

Gjithashtu fakti që në këshill formalisht vijnë për t’u trajtuar e konsultuar edhe akte që nuk kanë lidhje me pushtetin vendor, përbën

një qasje që duhet ndryshuar. Këshilli konsultativ duhet të ketë në themel të punës dhe aktivitetit të tij, shoqatat e të zgjedhurve vendorë dhe me ata duhet të ulet për të përcaktuar agjendën dhe planin e punës. Por ky këshill i organizuar nga Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, nuk e ka arritur këtë gjë.

Madje vihet re orientimi dhe tendenca nga aktorë të tjerë të shoqërisë civile, me projekte që të zënë hapësirën dhe agjendën në këshillin konsultativ me prezantim raportesh apo iniciativash të çfarëdoshme, por pa ndaluar këtu.

Por pavarësisht nga kjo situatë dhe qasje e këshillit konsultativ, Shoqata e Bashkive ka qenë pjesëmarrëse në 100% të takimeve, si dhe ka reaguar në përqindjen më të lartë të akteve të prezantuara, në rreth 90% krahasuar me aktorë të tjerë.

Por duhet theksuar se Shoqata e Bashkive të Shqipërisë ka pasur një bashkëpunim shumë të mirë me institucionet shqiptare, dhe vecanrishtë me ministrinë e brëndëshme që udhëheq reformën e decentralizimit, po ashtu me parlamentin, dhe agjensi të tjera duke qenë pjesë e diskutimeve të projekt-vendimeve apo dhënies së kontributit për tema të ndryshme.

Shoqata e Bashkive qëndron për një Dialog midis Qeverisjes Qendrore dhe asaj Vendore, bazuar në parime dhe ligjin përkatës. Dialog real për t'u dhënë zgjidhje problemeve dhe jo për shfaqje dhe jo një tryezë mundësish ku cilido mund të vijë dhe të flasë apo propozojë.

Për një partneritet efektiv rekomandojmë një përfshirje më të hershme të përfaqësuesve të qeverisjes vendore në formulimin e akteve që ndikojnë këtë nivel.

Roli i Shoqatave të Zgjedhurve Vendorë duhet të konsiderohet me prioritet për përfshirjen e hershme të qeverisjes vendore në vendimarrjen që lidhet me këtë nivel qeverisje.

Anekse - Fakte dhe shifra.

SHTOJCË

Tabela 4. Diferencat në vlerë absolute të të ardhurave nga burimet e veta vendore në nivel bashkie (në lekë)

NJQV	Të ardhurat nga taksat	Të ardhurat nga tarifat	Të ardhura të tjera	Totali
Himarë	79,868,556.00	(17,361,942.00)	3,563,880.00	69,503,226.00
Tiranë	133,111,783.00	(121,240,654.00)	42,376,536.00	61,758,747.00
Patos	5,245,657.00	65,088,415.00	(28,468.00)	43,297,472.00
Kukës	2,605,394.00	40,429,788.00	1,252,938.00	36,510,118.00
Vlorë	59,851,628.00	(31,721,545.00)	840,861.00	29,167,790.00
Berat	(24,820,138.00)	44,449,680.00	(9,247,500.00)	21,612,298.00
Sarandë	(783,129.00)	7,951,021.00	1,057,264.00	20,490,429.00
Dropulli	1,964,999.00	1,336,591.00	553,940.00	18,993,300.00
Pukë	5,510,371.00	11,225,651.00	999,928.00	18,535,892.00
Mat	1,079,280.00	11,516,485.00	623,296.00	13,214,920.00
Kolonjë	2,439,880.00	6,433,240.00	-	12,876,989.00
Belsh	9,841,671.00	9,271,480.00	-	12,081,995.00
Rrogozhinë	5,999,020.00	3,543,953.00	-	9,542,973.00
Pustec	(1,419,395.00)	1,226,873.00	-	9,426,558.00
Konispol	2,618,379.00	6,704,732.00	-	9,323,111.00
Finiq	1,538,324.00	140,094.00	-	9,313,128.00
Prrenjas	1,085,635.00	5,073,113.00	600,000.00	7,661,846.00
Delvinë	364,730.00	6,882,116.00	-	6,956,196.00
Ura Vajgurore	(15,978,882.00)	24,515,833.00	-	6,948,486.00
Cërrik	11,564,385.00	(5,540,027.00)	-	4,991,221.00
Has	1,037,583.00	(412,845.00)	470,196.00	4,032,555.00
Përmet	(4,183,236.00)	1,118,961.00	-	3,563,331.00
Polican	1,628,038.00	1,432,247.00	287,264.00	3,522,013.00
Gramsh	5,461,895.00	(3,127,080.00)	-	2,334,815.00
Memaliaj	885,907.00	1,428,980.00	-	2,314,887.00
Këlcyrë	86,148.00	548,942.00	-	635,090.00

Lushnjë	20,859,564.00	(14,168,572.00)	-	585,232.00
Pogradec	(3,108,935.00)	1,762,579.00	791,398.00	481,149.00
Maliq	(11,432,687.00)	11,140,047.00	-	266,693.00
Tepelenë	(484,767.00)	660,758.00	-	175,991.00
Libohovë	(764,928.00)	(417,987.00)	(55,046.00)	(1,237,961.00)
Librazhd	(4,855,660.00)	9,798,355.00	(50,868.00)	(2,271,311.00)
Malësi e Madhe	6,892,253.00	(8,974,252.00)	(3,672,014.00)	(4,212,483.00)
Fushë Arrëz	(2,991,723.00)	(3,640,071.00)	-	(7,345,666.00)
Gjirokastër	(9,799,947.00)	(4,875,667.00)	240,320.00	(7,612,873.00)
Bulqizë	(6,576,658.00)	(1,482,869.00)	-	(7,900,527.00)
Devoll	10,684,976.00	11,541,339.00	-	(8,137,754.00)
Tropojë	(10,453,409.00)	1,819,565.00	-	(8,633,844.00)
Selenicë	(4,534,760.00)	(5,030,619.00)	543,580.00	(8,653,219.00)
Divjakë	(4,913,736.00)	(4,634,957.00)	-	(9,780,693.00)
Klos	(9,601,133.00)	(1,500,326.00)	-	(10,640,959.00)
Mirditë	(929,847.00)	(7,727,723.00)	-	(12,869,260.00)
Peqin	(15,018,843.00)	1,255,278.00	-	(13,763,565.00)
Shijak	(12,458,399.00)	(3,938,724.00)	-	(15,708,114.00)
Skrapar	(1,287,850.00)	(24,863,867.00)	9,117,095.00	(16,900,507.00)
Dibër	(3,296,525.00)	(15,224,821.00)	992,782.00	(17,793,715.00)
Kurbin	(17,616,160.00)	(3,213,943.00)	543,916.00	(22,379,171.00)
Elbasan	(10,116,278.00)	(35,133,597.00)	9,238,706.00	(26,818,758.00)
Kuçovë	(18,546,625.00)	(9,924,013.00)	-	(28,633,339.00)
Roskovec	(16,804,847.00)	(18,652,059.00)	846,579.00	(31,284,330.00)
Vau I Dejës	(32,328,924.00)	(5,489,473.00)	-	(37,818,397.00)
Mallakastër	(7,657,011.00)	(31,466,057.00)	-	(39,123,068.00)
Krujë	(19,293,622.00)	(20,315,798.00)	7,813,366.00	(41,006,054.00)
Fier	22,310,413.00	(84,599,223.00)	(242,821.00)	(61,163,890.00)
Shkodër	(37,600,528.00)	(23,017,262.00)	(1,915,656.00)	(62,258,947.00)
Kavajë	(84,631,478.00)	505,154.00	-	(82,499,984.00)
Vorë	(113,899,223.00)	2,367,973.00	-	(111,531,250.00)
Korçë	(76,148,038.00)	(40,329,288.00)	(8,970,569.00)	(116,750,858.00)
Kamëz	(32,638,816.00)	(259,549,080.00)	(607,866.00)	(302,293,357.00)
Durrës	(192,879,954.00)	(96,445,088.00)	(1,800,605.00)	(307,054,896.00)
Lezhë	(367,580,454.00)	(15,891,939.00)	(444,493.00)	(383,481,758.00)
Totali	(782,900,076.00)	(628,742,125.00)	55,717,939.00	(1,367,442,057.00)

SHTOJCË

Tabela 6. Diferencat në vlerë absolute të shpenzimeve totale vendore në nivel bashkie (në lekë)

NJQV	Paga dhe sigurime	Operative dhe të tjera	Kapitale	Totali
Rrogozhinë	30,043,356.00	(11,004,082.00)	127,985,272.00	147,024,546.00
Prrenjas	8,733,868.00	24,387,280.00	41,409,048.00	74,530,196.00
Skrapar	(7,081,914.00)	15,292,096.00	57,459,781.00	65,669,963.00
Belsh	30,270,613.00	13,742,702.00	10,152,568.00	54,165,883.00
Pogradec	77,368,405.00	133,911,478.00	(162,087,939.00)	49,191,944.00
Gramsh	7,777,480.00	2,109,268.00	31,440,419.00	41,327,167.00
Kukës	8,034,557.00	(11,822,164.00)	41,464,413.00	37,676,806.00
Ura Vajgurore	20,941,091.00	15,144,571.00	(5,528,952.00)	30,556,710.00
Kolonjë	(10,156,085.00)	18,022,139.00	19,455,487.00	27,321,541.00
Fushë Arrëz	2,240,814.00	4,868,102.00	18,685,332.00	25,794,248.00
Himarë	(909,347.00)	(10,111,796.00)	36,748,772.00	25,727,629.00
Pukë	(276,469.00)	(4,930,024.00)	28,114,350.00	22,907,857.00
Dibër	(21,544,374.00)	13,965,830.00	18,844,943.00	11,266,399.00
Dropulli	7,499,432.00	(4,652,945.00)	6,296,188.00	9,142,675.00
Mirditë	3,511,932.00	27,702,381.00	(23,821,300.00)	7,393,013.00
Konispol	1,591,830.00	7,304,564.00	(2,721,563.00)	6,174,831.00
Përmet	(468,782.00)	2,917,938.00	2,716,665.00	5,165,821.00
Pustec	2,685,665.00	(2,322,765.00)	4,492,553.00	4,855,453.00
Libohovë	2,185,977.00	6,949,219.00	(4,963,775.00)	4,171,421.00
Polican	(9,866,550.00)	9,385,296.00	3,163,881.00	2,682,627.00
Shijak	8,071,837.00	(30,270,179.00)	23,532,307.00	1,333,965.00
Divjakë	2,981,551.00	(27,608,692.00)	25,678,274.00	1,051,133.00
Tepelenë	1,443,252.00	2,424,348.00	(3,339,917.00)	527,683.00
Delvinë	(1,066,232.00)	10,938,771.00	(10,930,703.00)	(1,058,164.00)
Peqin	24,251,721.00	(7,623,270.00)	(21,661,835.00)	(5,033,384.00)
Mat	(3,196,405.00)	11,763,857.00	(14,749,104.00)	(6,181,652.00)
Has	12,789,045.00	(7,845,960.00)	(20,508,047.00)	(15,564,962.00)
Këlcyrë	(1,151,078.00)	(6,308,090.00)	(12,243,693.00)	(19,702,861.00)
Lushnjë	22,480,828.00	(3,966,922.00)	(43,783,223.00)	(25,269,317.00)
Cërrik	(17,709,258.00)	11,982,998.00	(22,562,488.00)	(28,288,747.00)

Selenicë	1,736,269.00	14,787,457.00	(46,150,824.00)	(29,627,098.00)
Vlorë	69,440,639.00	(77,621,521.00)	(21,709,441.00)	(29,890,323.00)
Kurbin	(1,758,369.00)	18,622,640.00	(47,532,163.00)	(30,667,892.00)
Devoll	14,301,284.00	10,130,447.00	(55,761,368.00)	(31,329,637.00)
Maliq	6,857,557.00	4,944,655.00	(46,168,921.00)	(34,366,709.00)
Memaliaj	2,132,041.00	(2,948,463.00)	(37,975,680.00)	(38,792,102.00)
Sarandë	18,250,111.00	(58,657,018.00)	692,898.00	(39,714,009.00)
Librazhd	(11,913,600.00)	7,520,923.00	(37,153,120.00)	(41,545,797.00)
Roskovec	(2,243,163.00)	(521,700.00)	(42,555,844.00)	(45,320,707.00)
Kucovë	(4,467,101.00)	(7,540,197.00)	(39,243,208.00)	(51,250,506.00)
Klos	(16,305,493.00)	4,233,183.00	(40,023,922.00)	(52,096,232.00)
Finiq	(16,886,143.00)	1,673,921.00	(38,681,261.00)	(53,893,483.00)
Elbasan	8,597,113.00	30,615,665.00	(93,427,907.00)	(54,215,129.00)
Tropojë	957,163.00	(28,361,752.00)	(28,340,430.00)	(55,745,019.00)
Berat	(13,901,318.00)	82,731,461.00	(134,047,812.00)	(65,217,669.00)
Gjirokastër	(13,016,562.00)	(20,843,362.00)	(33,910,828.00)	(67,770,751.00)
Patos	2,678,253.00	(5,492,424.00)	(87,454,615.00)	(90,268,786.00)
Kavajë	(5,088,358.00)	(64,503,827.00)	(21,112,622.00)	(90,704,807.00)
Malësi e Madhe	7,885,929.00	323,024.00	(112,185,348.00)	(103,976,395.00)
Bulqizë	8,991,340.00	(509,351.00)	(119,126,549.00)	(110,644,560.00)
Fier	554,927.00	14,926,505.00	(147,831,321.00)	(132,349,889.00)
Krujë	(6,499,861.00)	(23,029,989.00)	(105,044,195.00)	(134,574,045.00)
Korcë	12,330,962.00	(33,115,766.00)	(189,818,952.00)	(210,603,756.00)
Vau i Dejës	37,591,492.00	1,798,391.00	(281,932,200.00)	(242,542,317.00)
Vorë	1,992,704.00	(71,258,389.00)	(204,913,900.00)	(274,179,585.00)
Mallakastër	(2,612,600.00)	(40,035,642.00)	(267,941,125.00)	(310,589,367.00)
Shkodër	5,512,243.00	(98,758,967.00)	(220,347,872.00)	(313,594,596.00)
Lezhë	(77,797,540.00)	(105,292,779.00)	(147,097,777.00)	(330,188,096.00)
Kamëz	22,396,228.00	(23,479,808.00)	(369,069,137.00)	(370,152,717.00)
Durrës	10,572,881.00	(58,763,837.00)	(410,072,888.00)	(458,263,844.00)
Tiranë	297,046,363.00	197,792,728.00	(1,707,578,398.00)	(1,212,739,308.00)
Totali	558812151.00	(126,287,843.00)	(4,984,779,016.00)	(4,552,254,707.00)

SHTOJCË

Stoku i detyrimeve për bashkitë deri në dhjetor 2020

Stoku i Detyrimeve deri në Dhjetor 2020	Total	Stock of Arrears until December 2020
TOTAL (milion LEK)	6931.3	
Bashkia Tiranë	761.8	<i>Municipality of Tiranë</i>
Bashkia Kavajë	727.8	<i>Municipality of Kavajë</i>
Bashkia Vorë	702.6	<i>Municipality of Vorë</i>
Bashkia Pogradec	338.8	<i>Municipality of Pogradec</i>
Bashkia Lezhë	308.4	<i>Municipality of Lezhë</i>
Bashkia Roskovec	302.3	<i>Municipality of Roskovec</i>
Bashkia Kamëz	265.4	<i>Municipality of Kamëz</i>
Bashkia Vlorë	256.6	<i>Municipality of Vlorë</i>
Bashkia Malësi e Madhe	223.9	<i>Municipality of Malësi e Madhe</i>
Bashkia Durrës	185.5	<i>Municipality of Durrës</i>
Bashkia Dibër	174.8	<i>Municipality of Dibër</i>
Bashkia Kuçove	156.4	<i>Municipality of Kuçove</i>
Bashkia Elbasan	153.8	<i>Municipality of Elbasan</i>
Bashkia Berat	143.4	<i>Municipality of Berat</i>
Bashkia Lushnjë	134.9	<i>Municipality of Lushnjë</i>
Bashkia Divjakë	130.3	<i>Municipality of Divjakë</i>
Bashkia Belsh	128.2	<i>Municipality of Belsh</i>
Bashkia UraVajgurore	124.1	<i>Municipality of UraVajgurore</i>
Bashkia Tropojë	119.3	<i>Municipality of Tropojë</i>
Bashkia Rrogozhinë	113.2	<i>Municipality of Rrogozhinë</i>
Bashkia Cërrik	111.6	<i>Municipality of Cërrik</i>
Bashkia Poliçan	102.7	<i>Municipality of Poliçan</i>
Bashkia Selenicë	99.0	<i>Municipality of Selenicë</i>
Bashkia Fier	88.4	<i>Municipality of Fier</i>
Bashkia Himarë	75.2	<i>Municipality of Himarë</i>
Bashkia Kukës	72.7	<i>Municipality of Kukës</i>
Bashkia Mirditë	67.0	<i>Municipality of Mirditë</i>
Bashkia Pukë	59.3	<i>Municipality of Pukë</i>

Bashkia Klos	58.4	<i>Municipality of Klos</i>
Bashkia Tepelenë	58.1	<i>Municipality of Tepelenë</i>
Bashkia Devoll	57.2	<i>Municipality of Devoll</i>
Bashkia Sarandë	57.2	<i>Municipality of Sarandë</i>
Bashkia Librazhd	55.8	<i>Municipality of Librazhd</i>
Bashkia Korçë	53.3	<i>Municipality of Korçë</i>
Bashkia Delvinë	51.8	<i>Municipality of Delvinë</i>
Bashkia Finiq	50.2	<i>Municipality of Finiq</i>
Bashkia Krujë	50.1	<i>Municipality of Krujë</i>
Bashkia Peqin	32.3	<i>Municipality of Peqin</i>
Bashkia Skrapar	29.6	<i>Municipality of Skrapar</i>
Bashkia Bulqize	28.3	<i>Municipality of Bulqize</i>
Bashkia Has	27.5	<i>Municipality of Has</i>
Bashkia Memaliaj	24.5	<i>Municipality of Memaliaj</i>
Bashkia Mat	19.9	<i>Municipality of Mat</i>
Bashkia Gramsh	19.6	<i>Municipality of Gramsh</i>
Bashkia Prrenjas	16.2	<i>Municipality of Prrenjas</i>
Bashkia Kurbin	15.8	<i>Municipality of Kurbin</i>
Bashkia Maliq	14.2	<i>Municipality of Maliq</i>
Bashkia Konispol	13.6	<i>Municipality of Konispol</i>
Bashkia Kolonjë	12.2	<i>Municipality of Kolonjë</i>
Bashkia Mallakastër	10.5	<i>Municipality of Mallakastër</i>
Bashkia Shijak	9.6	<i>Municipality of Shijak</i>
Bashkia Libohovë	8.0	<i>Municipality of Libohovë</i>
Bashkia Fushë-Arrëz	8.0	<i>Municipality of Fushë-Arrëz</i>
Bashkia Vau-Dejes	7.8	<i>Municipality of Vau-Dejes</i>
Bashkia Përmet	6.2	<i>Municipality of Përmet</i>
Bashkia Gjirokastër	3.3	<i>Municipality of Gjirokastër</i>
Bashkia Shkodër	3.2	<i>Municipality of Shkodër</i>
Bashkia Pustec	1.5	<i>Municipality of Pustec</i>
Bashkia Patos	0	<i>Municipality of Patos</i>
Bashkia Këlcyrë	0	<i>Municipality of Këlcyrë</i>
Bashkia Devoll	0	<i>Municipality of Devoll</i>

INSTITUCIONET VENDORE												
Stoku i Detyrimeve dhe i Dajtor 2020	Vendime Gjyqesore	Sherbime	Mirembajtje	Investime	Rimbursim i TVSH	Mallra	Te tjera	Sigurime Shogjore	Sigurime shendetesore	Te Ardhura Personale	Tatime te Tjera	Total
TOTAL (milion LEK)	814.3	718.6	247.3	3,770.0	1.8	246.7	1,197.6	31.1	2.8	20.5	8.4	7,058.9
Tiranë	41.5	29.9	4.0	418.5	-	80.7	187.1	-	-	-	0.1	761.8
Kavajë	63.3	42.1	-	114.5	-	-	507.9	-	-	-	-	727.8
Vorë	7.5	-	108.0	587.1	-	-	-	-	-	-	-	702.6
Pogradec	118.9	95.8	1.8	82.0	-	12.5	18.7	7.6	1.1	0.4	-	338.7
Lezhë	2.3	57.1	0.0	113.8	-	7.4	127.8	-	-	-	-	308.4
Roskovec	0.5	8.9	4.3	283.6	-	4.8	0.2	-	-	-	-	302.2
Kamëz	2.0	55.3	-	208.1	-	-	-	-	-	-	-	265.4
Vlorë	-	14.5	59.1	53.0	-	13.2	116.8	-	-	-	-	256.6
Malësi e Madhe	16.5	-	-	207.4	-	-	-	-	-	-	-	223.9
Durrës	137.3	-	-	48.2	-	-	-	-	-	-	-	185.4
Dibër	108.1	9.9	0.1	37.4	-	9.7	0.8	1.8	0.3	6.7	0.0	174.6
Kuçovë	0.5	16.2	-	126.5	-	0.3	12.9	-	-	-	-	156.3

Elbasan	1.6	47.3	4.9	78.2	-	21.1	0.7	-	-	-	-	153.9
Berat	9.7	22.7	-	82.9	-	5.5	22.6	-	-	-	-	143.3
Lushnjë	1.0	11.6	11.4	104.1	-	5.7	1.1	-	-	-	-	134.8
Divjakë	2.5	4.7	1.0	87.1	-	25.7	9.3	-	-	-	-	130.2
Belsh	-	10.0	-	117.8	-	0.4	0.0	-	-	-	-	128.2
Ura Vajgurore	16.9	4.6	6.7	69.6	-	-	26.3	-	-	-	-	124.1
Tropojë	11.1	1.2	13.2	93.7	-	0.1	-	-	-	-	-	119.3
Rrogozhinë	-	24.3	-	88.4	-	-	0.5	-	-	-	-	113.2
Cërrik	1.4	4.1	3.8	86.2	-	7.3	8.8	-	-	-	-	111.8
Polliçan	8.2	18.9	-	54.3	-	-	21.3	-	-	-	-	102.7
Selenicë	20.2	7.3	-	58.3	-	3.5	8.7	0.4	-	-	0.6	99.0
Fier	0.0	10.0	0.2	68.6	-	-	9.6	-	-	-	-	88.5
Himarë	0.1	4.1	-	61.3	-	0.8	8.9	-	-	-	-	75.2
Kukës	3.1	5.1	0.0	13.0	-	0.2	9.6	20.4	1.4	13.2	6.7	72.7
Mirditë	-	22.2	0.0	34.1	-	2.8	7.9	-	-	-	-	66.9
Qarku Durrës	63.1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	63.1
Pukë	10.1	5.7	-	43.5	-	-	-	-	-	-	-	59.3
Klos	2.5	3.2	1.1	47.0	-	1.4	3.2	-	-	-	-	58.4
Tepelenë	5.7	7.0	5.1	11.5	-	15.3	13.5	-	-	-	-	58.1

Devoll	4.9	30.1	-	6.9	-	-	14.4	0.1	-	0.1	0.7	57.3
Sarandë	8.5	46.2	-	0.9	-	1.6	-	-	-	-	-	57.2
Librazhd	1.9	0.3	0.1	53.5	-	-	-	-	-	-	-	55.8
Korçë	4.8	17.3	13.6	12.2	-	5.4	-	-	-	-	-	53.3
Delvinë	2.4	8.4	-	39.9	-	1.1	-	-	-	-	-	51.8
Finiq	0.1	0.1	-	25.1	1.8	2.5	20.6	-	-	-	-	50.1
Krujë	9.4	1.4	0.0	36.2	-	-	3.1	-	-	-	-	50.0
Qarku Berat	41.3	0.0	-	0.7	-	-	0.1	-	-	-	-	42.2
Peqin	9.9	3.4	0.7	12.6	-	1.3	4.4	-	-	-	-	32.3
Skrapar	8.5	0.5	4.7	3.6	-	0.1	12.2	-	-	-	-	29.6
Bulqize	-	-	0.5	27.8	-	-	-	-	-	-	-	28.3
Has0.4	-	-	25.4	-	1.7	-	-	-	-	-	27.5	
Memaliaj	0.2	13.8	1.5	1.2	-	1.8	6.0	-	-	-	-	24.3
Mat3.8	9.9	-	-	-	5.3	0.3	0.4	0.1	-	0.1	19.9	
Gramsh	8.0	4.5	-	5.5	-	1.6	-	-	-	-	-	19.7
Qarku Gjirokastr	16.5	-	-	-	-	1.0	1.3	-	-	-	-	18.7
Prrerjas	3.2	12.9	0.0	0.1	-	-	-	-	-	-	-	16.2
Kurbin	8.0	2.0	-	5.8	-	-	-	-	-	-	-	15.8
Maliq	2.5	8.6	-	1.6	-	1.5	-	-	-	-	-	14.1

Konispol	-	9.3	-	-	-	-	-	-	0.4	-	-	-	0.2	13.6
Kolonjë	8.3	1.5	0.9	-	-	1.5	-	-	-	-	-	-	-	12.2
Mallakastër	0.9	0.1	-	2.9	-	-	-	-	6.6	-	-	-	-	10.6
Shijak	-	-	-	9.6	-	-	-	-	-	-	-	-	-	9.6
Libohovë	-	0.2	0.4	7.4	-	-	-	-	-	-	-	-	-	8.0
Fushë-Arrëz	8.0	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	8.0
Vau-Dejes	3.3	-	-	4.5	-	-	-	-	-	-	-	-	-	7.8
Përmet	1.7	2.3	-	2.2	-	-	-	-	-	-	-	-	-	6.3
Gjirokastër	1.0	0.1	-	1.1	-	1.1	-	-	-	-	-	-	-	3.3
Shkodër	-	-	-	3.2	-	-	-	-	-	-	-	-	-	3.2
Qarku Korçë	1.4	0.8	-	-	-	0.3	-	-	0.6	-	-	-	-	3.0
Pustec	-	0.2	-	0.5	-	0.8	-	-	-	-	-	-	-	1.4
Qarku Vlorë	-	1.3	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1.3

SHTOJCË

Tabela 8. Numri i punonjësve të NJQV për periudhën 2019-2020

Nr.	Emërtimi	2019	2020	Diferenca në vlerë	Diferenca në përqindje (%)
1	Bashkia Pogradec	682	812	130	19%
2	Bashkia Dropull	112	132	20	18%
3	Bashkia Devoll	262	298	36	14%
4	Bashkia Peqin	253	286	33	13%
5	Bashkia Mat	377	423	46	12%
6	Bashkia Vau-Dejës	316	354	38	12%
7	Bashkia Pustec	69	77	8	12%
8	Bashkia Përmet	283	311	28	10%
9	Bashkia Rrogozhinë	266	292	26	10%
10	Bashkia Ura Vajgurore	256	281	25	10%
11	Bashkia Mallakastër	374	406	32	9%
12	Bashkia Klos	214	231	17	8%
13	Bashkia Kurbin	372	401	29	8%
14	Bashkia Tirana	6,728	7216	488	7%
15	Bashkia Shijak	261	276	15	6%
16	Bashkia Durrës	1571	1652	81	5%
17	Bashkia Kukës	669	703	34	5%
18	Bashkia Malësi e Madhe	354	370	16	5%
19	Bashkia Tropojë	295	306	11	4%
20	Bashkia Shkodër	918	951	33	4%
21	Bashkia Divjakë	431	446	15	3%
22	Bashkia Maliq	538	554	16	3%
23	Bashkia Vlorë	1,002	1031	29	3%
24	Bashkia Lushnjë	874	897	23	3%
25	Bashkia Belsh	197	202	5	3%
26	Bashkia Prenjas	294	301	7	2%
27	Bashkia Pukë	272	278	6	2%
28	Bashkia Gjirokastrë	592	602	10	2%
29	Bashkia Has	241	245	4	2%

30	Bashkia Gramsh	312	317	5	2%
31	Bashkia Sarandë	382	388	6	2%
32	Bashkia Kavaja	566	574	8	1%
33	Bashkia Korçë	1,008	1,022	14	1%
34	Bashkia Libohovë	87	88	1	1%
35	Bashkia Himarë	175	177	2	1%
36	Bashkia Memaliaj	185	187	2	1%
37	Bashkia Fushë-Arrëz	214	216	2	1%
38	Bashkia Patos	354	357	3	1%
39	Bashkia Delvinë	179	180	1	1%
40	Bashkia Këlcyrë	186	187	1	1%
41	Bashkia Kucovë	371	371	0	0.00%
42	Bashkia Librazhd	397	397	0	0.00%
43	Bashkia Fier	1311	1307	-4	-0.31%
44	Bashkia Elbasan	1,374	1369	-5	-0.36%
45	Bashkia Selenicë	232	231	-1	-0.43%
46	Bashkia Konispol	123	122	-1	-1%
47	Bashkia Bulqizë	378	371	-7	-2%
48	Bashkia Finiq	195	191	-4	-2%
49	Bashkia Mirditë	382	371	-11	-3%
50	Bashkia Berat	711	687	-24	-3%
51	Bashkia Krujë	539	518	-21	-4%
52	Bashkia Tepelenë	235	225	-10	-4%
53	Bashkia Roskovec	337	321	-16	-5%
54	Bashkia Vorë	416	393	-23	-6%
55	Bashkia Lezhë	779	727	-52	-7%
56	Bashkia Skrapar	379	352	-27	-7%
57	Bashkia Kolonjë	278	257	-21	-8%
58	Bashkia Dibër	804	741	-63	-8%
59	Bashkia Kamëz	643	590	-53	-8%
60	Bashkia Cërrik	293	263	-30	-10%
61	Bashkia Polican	248	216	-32	-13%
	TOTALI	33,146	34,047	901	

Aneks 1

Raporti Vjetor OSBE 2019

Për herë të parë në 20 vjet, opozita bojkotoi zgjedhjet vendore të 30 qershorit duke bërë që Partia Socialiste të vendoste kontroll dhe në të gjitha bashkitë. Në pjesën e dytë të 2019, opozita jashtë parlamentare bëri disa përpjekje të delegjitimonte zgjedhjet vendore dhe të kërkonte dorëheqjen e qeverisë, duke u bazuar dhe në Vendimin e Këshillit të BE të tetorit 2019 për të shtyrë negociatat e pranimit. Në 30 qershor 2019, zgjedhjet vendore u zhvilluan në një klimë përçarëse dhe të tensionuar politike. Më herët, në 8 qershor, Presidenti Ilir Meta shpalli vendimin për të anuluar zgjedhjet e 30 qershorit me qëllim mbrojtjen e vendit ndaj kërcënimeve të sigurisë dhe stabilitetit dhe për të mundësuar një moment reflektimi për qeverinë dhe opozitën. Më tej, ai dekretoi 13 tetorin 2019 si data e re e zgjedhjeve vendore, datë të cilën qeveria refuzoi ta merrte në konsideratë. Para zgjedhjeve, komuniteti ndërkombëtar kishte paralajmëruar se dhuna gjatë proecsit zgjedhor do të ishte e papranueshme. Pas zgjedhjeve, Raporti Përfundimtar i Misionit të Monitorimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR vuri re se pavarësisht se zgjedhjet ishin organizuar pa probleme madhore, ato nuk

¹ The EU, OSCE, U.S., and several bilateral embassies in Tirana.

https://www.facebook.com/osce.Albania/posts/880299475657234?_tn_=-R;

<https://www.facebook.com/usembassytirana/posts/10156471993735838>

https://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage/6471/statement-european-union-delegationalbania_en

<https://twitter.com/UKinAlbania/status/1144600216018071553/photo>

<https://www.facebook.com/AmbasadaGjermaneTirana/photos/a.10150847782613553/10156036546701353//type=e=3&theatre>

<https://www.facebook.com/SwedeninAL/photos/a.525744017455655/2836935406336493/?type=3%theater>

kishin pasur parasysh interesin e zgjedhësve; zgjedhësit nuk kishin mundësi zgjedhjeje të alternativave politike pasi partitë opozitare kishin bojkotuar procesin.

Raporti i Progresit të BE 2019

Për qeverisjen vendore, reforma administrative territoriale duhet të konsolidohet më tej si pjesë e axhendës më të gjerë të decentralizimit. Qeveria kreu një rishikim afatmesëm të Strategjisë Ndërsektoriale Kombëtare 2015-2020 për decentralizimin dhe qeverisjen lokale. Kontrolli i Lartë i Shtetit gjithashtu kreu një vlerësim të reformës dhe hartoi një raport në tetor 2018. Legjislacioni i ri me ndikim në qeverisjen vendore nuk është i harmonizuar ende dhe nuk është zbatuar plotësisht. Më e rëndësishmja është se ndërsa bashkive u është dhënë fuqi më e madhe, mjaftueshmëria e burimeve financiare në dispozicion të njësive të qeverisjes vendore (NJQV) është në rrezik. Autonomia fiskale e NJQV-ve është gjithashtu në rrezik. 73% e buxhetit të NJQV-ve vjen nga transfertat e qeverisë. Buxheti i shtetit alokon rreth 1% të PBB-së për NJQV-të, më e ulta në Ballkanin Perëndimor. Në shumicën e bashkive, NJQV-të nuk janë efektive në mbledhjen e të ardhurave. Si rezultat, aftësia e përgjithshme e institucioneve lokale për të ofruar shërbime publike cilësore mbetet e kufizuar. Emërimet jo plotësisht në përputhje me të gjitha parimet e ligjit të shërbimit civil kanë penguar krijimin e një shërbimi civil plotësisht të bazuar në merita.

Raporti i Progresit të BE 2020

Më 30 qershor 2019, u organizuan zgjedhjet lokale në një mjedis politik shumë të polarizuar. Pas heqjes dorë nga mandatet parlamentare në shkurt 2019 dhe muajve të protestave në rrugë, opozita vendosi të bojkotojë zgjedhjet. Më 8 qershor, për shkak të kërcënimeve të

sigurisë, Presidenti dekretoi anulimin e dekretit të tij të mëparshëm që përcaktonte datën e zgjedhjeve dhe shpalli 13 tetorin si datë të re. Dekreti i Presidentit u injorua nga shumica në pushtet dhe organet e administratës zgjedhore. Ndërsa opozita jashtë-parlamentare u përpoq të delegjitime zgjedhjet, bashkësia ndërkombëtare paralajmëroi se dhuna gjatë procesit zgjedhor do të konsiderohej e papranueshme. Kandidatët për kryetar bashkie nga Partia Socialiste (PS) në pushtet garuan pa kundërshtim në 31 nga 61 bashki, nga të cilat PS fitoi 60 (pjesa e mbetur u fitua nga një parti e vogël e mbështetur nga PS). Pas zgjedhjeve, Parlamenti nisi procedurën hetimore kundër Presidentit për shkak të antikushtetutshmërisë së vendimit të tij për të anuluar datën e zgjedhjeve. Komisioni hetimor ad hoc i Parlamentit arriti në përfundimin se ndërsa Presidenti kishte tejkaluar kompetencat e tij kushtetuese, shkelja nuk përbënte arsye të mjaftueshme për shkarkimin e Presidentit. Parlamenti miratoi vendimin e komisionit ad hoc të hetimit më 27 korrik 2020.

Kongresi përmyll misionin e nivelit të lartë në Shqipëri

“Për fat të keq, zgjedhjet lokale të 2019 nuk ishin të favorshme për forcimin e demokracisë vendore në Shqipëri, por kanë çuar në më pak pluralizëm në bashki dhe në një erozion të mëtejshëm të besimit të qytetarëve në institucionet e këtij vendi”, deklaroi Gunn-Marit Helgesen, President i Dhomës së Rajoneve të Kongresit. “Si qeveria ashtu edhe opozita nuk duhet të qëndrojnë indiferentë përpara një situatë të tillë dhe duhet të veprojnë në një mënyrë të përgjegjshme, sipas roleve të tyre specifike në procesin demokratik, në mënyrë që të sigurojnë zgjedhje duke ofruar një zgjedhje pluraliste për votuesit, si në nivelin kombëtar ashtu edhe në atë lokal”, theksoi Helgesen.

<https://www.coe.int/en/web/congress/-/congress-concludes-high-level-mission-in-albania>

Aneks 2

Shkresa nga Gjykata Kushtetuese



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE

Drejtoria Gjyqësore dhe e Dokumentacionit

Nr. S-7 i Aktit

Tiranë, më 23.01.2020

Lënda: Informacion mbi fazën e kërkesës drejtuar Gjykatës Kushtetuese

SHOQATËS SË BASHKIVE TË SHQIPËRISË

Rruga "Skerdilajd Llagami", Ndërtesa nr.3, Ap.8

TIRANË

Ju njoftojmë se në shqyrtimin paraprak të kërkesës suaj, me objekt: *"1. Konstatimin antikushtetues të zgjedhshmërisë/procesit zgjedhor të zhvilluar në 30 qershor 2019, për zgjedhjen e organeve të qeverisjes vendore, të kryetarëve të bashkive dhe anëtarëve të këshillave bashkiakë, dhe si rrjedhojë konstatimin antikushtetues të zgjedhjes së anëtarëve të këtyre organeve, në kundërshtim me nenet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 13, 15, 17, 18, 22, 42, 43, 45, 48, 65, 92, 93, 109, 116, 122 dhe 145 germat d), e), dhe f); 131 germa h), pika 1, e nenit 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. 2. Verifikimin e kushtetutshmërisë së veprimtarisë së partisë Bindja Demokratike në lidhje me regjistrimin e saj në gjykatë dhe zgjedhjet e datës 30 qershor 2019 në përputhje me germën d të nenit 131 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë."*, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, me datë 24.12.2019, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak Mbledhjes së Gjyqtarëve.

Ju bëjmë me dije, gjithashtu, se shqyrtimi paraprak i kësaj kërkesë nga Mbledhja e Gjyqtarëve do të bëhet sapo Gjykata Kushtetuese të ketë kuorumin e nevojshëm për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 31/a, pika 1 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", të ndryshuar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!



Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr.26. dgjid@gjk.gov.al

SHTOJCA

Parashikimi i transfertës së pakushtëzuar e përgjithshme për bashkitë dhe qarqet për periudhën 2021-2023

(Në mijë lekë)

Bashkia	2020*	2021 (P)	2022 (P)	2023 (P)
Bashkia Belsh	119,458	124,629	132,252	140,516
Bashkia Berat	293,099	306,884	326,291	347,328
Bashkia Bulqize	261,586	272,105	288,961	307,233
Bashkia Cerrik	140,804	147,169	156,132	165,846
Bashkia Delvine	65,565	68,322	72,561	77,156
Bashkia Devoll	189,509	197,411	209,557	222,723
Bashkia Diber	409,240	426,257	452,377	480,692
Bashkia Divjake	210,800	219,688	232,788	246,988
Bashkia Dropull	80,991	84,176	89,439	95,143
Bashkia Durres	842,614	885,003	944,677	1,009,364
Bashkia Elbasan	675,697	706,929	750,897	798,559
Bashkia Fier	594,627	622,593	661,965	704,644
Bashkia Finiq	118,538	123,229	130,778	138,960
Bashkia Fushe Arrez	77,686	80,723	85,723	91,143
Bashkia Gjirokaster	210,664	219,706	233,600	248,661
Bashkia Gramsh	212,298	220,783	234,391	249,141
Bashkia Has	141,374	147,060	156,165	166,035
Bashkia Himare	118,403	123,122	130,907	139,347
Bashkia Kamez	504,614	526,871	558,205	592,172
Bashkia Kavaje	214,912	225,020	239,250	254,676
Bashkia Kelcyre	60,191	62,602	66,471	70,666
Bashkia Klos	137,653	143,136	151,927	161,457
Bashkia Kolonje	120,195	124,887	132,622	141,006
Bashkia Konispol	59,580	78,022	82,823	88,028

* Nuk përfshin shtesat në Transfertën e Pakushtëzuar nga Kuvendi.
Burimi Ministria e Financave

Bashkia Korce	449,034	469,158	498,827	530,988
Bashkia Kruje	283,848	296,757	314,931	334,632
Bashkia Kucove	161,955	169,292	179,621	190,818
Bashkia Kukes	318,971	332,307	352,764	374,940
Bashkia Kurbin	228,683	239,287	254,215	270,397
Bashkia Lezhe	325,524	340,834	362,388	385,752
Bashkia Libohove	41,356	42,996	45,699	48,629
Bashkia Librazhd	273,492	284,413	301,924	320,906
Bashkia Lushnje	400,677	419,320	445,566	474,016
Bashkia Malesi e Madhe	290,957	302,632	321,374	341,689
Bashkia Maliq	293,303	305,458	324,138	344,387
Bashkia Mallakaster	158,882	165,765	175,911	186,909
Bashkia Mat	187,686	195,483	207,457	220,436
Bashkia Memaliaj	103,316	107,434	114,045	121,211
Bashkia Mirdite	201,236	209,298	222,239	236,267
Bashkia Patos	126,611	132,144	139,935	148,380
Bashkia Peqin	128,273	134,036	142,148	150,942
Bashkia Permet	118,211	122,856	130,513	138,812
Bashkia Pogradec	356,705	372,291	395,256	420,151
Bashkia Polican	99,488	103,400	109,680	116,488
Bashkia Prrenjas	170,645	177,698	188,523	200,257
Bashkia Puke	111,972	116,353	123,568	131,388
Bashkia Pustec	34,566	35,901	38,105	40,494
Bashkia Roskovec	109,778	114,597	121,381	128,736
Bashkia Rrogozhine	142,093	148,225	157,265	167,065
Bashkia Sarande	129,131	135,465	144,383	154,049
Bashkia Selenice	167,390	174,037	184,711	196,281
Bashkia Shijak	134,908	141,254	150,186	159,869
Bashkia Shkoder	648,181	678,468	721,106	767,326
Bashkia Skrapar	122,367	127,247	135,284	143,997
Bashkia Tepelene	82,198	100,963	107,348	114,269

Bashkia Tirane	2,424,942	2,548,703	2,722,936	2,911,802
Bashkia Tropoje	206,870	214,974	228,306	242,757
Bashkia Ura Vajgurore	136,631	142,637	151,094	160,261
Bashkia Vau i Dejes	220,570	229,810	244,017	259,417
Bashkia Vlore	543,546	569,110	605,100	644,113
Bashkia Vore	118,949	124,543	132,419	141,106
Total	15,913,043	16,661,473	17,715,121	18,857,421

Qarqet	2020	2021	2022	2023
Qarku Berat	33,686	36,782	39,847	41,073
Qarku Dibër	37,003	40,416	43,784	45,131
Qarku Durrës	35,723	38,927	42,171	43,468
Qarku Elbasan	58,786	64,185	69,534	71,674
Qarku Fier	39,851	43,479	47,102	48,552
Qarku Gjirokastër	36,952	40,432	43,801	45,149
Qarku Korçë	57,758	63,124	68,385	70,489
Qarku Kukës	36,192	39,380	42,662	43,974
Qarku Lezhë	32,593	35,520	38,480	39,664
Qarku Shkodër	56,661	61,708	66,851	68,908
Qarku Tiranë	80,861	88,055	95,393	98,328
Qarku Vlorë	43,933	47,992	51,991	53,591
Total	550,000	600,000	650,000	670,000

